OSHEE OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A.

Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë

NIPT: K72410014H

PASQYRAT FINANCIARE

PËR

VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

Tiranë më 20.12.2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Pasqyrat financiare	
- Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2017	3
- Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të ardhurave tjera gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	4
- Pasqyra e Flukseve Monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	5
- Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	6
- Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare	7-58

OSHEE SH.A
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(Shumat janë shprehur në000/ lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

	Shënime	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	5	38,512,254	29,372,182
Aktive afatgjata jomateriale	6	805,182	512,341
Aktive financiare	7	1,461	1,607
		39,318,896	**29,886,130**
Aktivet afatshkurtra			
Inventarët	9	6,043,898	4,468,808
Llogari të Arkëtueshme tregtare, neto	10	20,932,065	20,515,613
Të tjera të arkëtueshme, neto	11	6,229,972	348,719
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12	1,710,861	1,289,996
Mjete monetare të ngurtësuara	12	2,424,915	5,449,899
Parapagimet për tatim fitimin		0	0
		37,341,712	**32,073,035**
TOTALI I AKTIVEVE		**76,660,608**	**61,959,165**
PASIVET DHE KAPITALI			
Kapitali dhe rezerva të disponueshme për Aksionerët			
Kapital aksionar	13	30,083,349	30,083,349
Rezerva rivlerësim astesh		1,250,030	1,513,463
Rezerva të tjera	13	2,916,011	2,916,011
Humbje të akumuluara	13	(69,292,022)	(88,770,269)
Të ardhura neto vjetore		1,830,160	18,719,938
Kapitali total		**(33,212,472)**	**(35,537,506)**
DETYRIMET			
Detyrimet afatgjata			
Huatë afatgjata neto	14	10,540,409	11,119,314
Provigjione		0	0
		10,540,409	**11,119,314**
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme	15	72,197,636	45,817,313
Detyrimet për taksa dhe sigurimet shoqërore	16	2,672,876	8,195,822
Detyrim për tatim fitimin	19	5,610,933	5,442,125
Pjesa afatshkurtër e huave afatgjatë	14	7,205,076	6,624,743
Huatë afatshkurtra		1,000,000	0
Detyrime të tjera afatshkurtra	17	7,661,495	14,673,562
Provigjione	18	2,984,656	5,623,792
		99,332,671	**86,377,357**
Detyrimet totale		**109,873,080**	**97,496,671**
TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT		**76,660,608**	**61,959,165**

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese pjesë përbërëse të pasqyrave financiare nga faqja 7 deri 58 .

ADMINSTRATORI
Adrian ÇELA

DREJTORI EKONOMIK
Ceno KLOSI

OSHEE SH.A

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHPERFSHIRESE

Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(Shumat janë shprehur ne000/leke, përveç kur përmendet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Të ardhurat	19	53,542,863	51,808,210
Të ardhura të tjera	20	6,889,472	10,215,645
Të ardhurat operative		**60,432,335**	**62,023,855**
Energjia e blerë	21	(34,966,858)	(21,737,924)
Tarifa e transmetimit	21	(4,639,553)	(3,927,551)
Lëndë e parë dhe materiale konsumi të përdorura	9	(929,785)	(976,205)
Shpenzime për personelin	22	(6,254,604)	(5,001,793)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5	(2,528,909)	(1,835,305)
Shpenzime të tjera	23	(7,690,145)	(6,348,813)
Shpenzimet operative		**(57,009,854)**	**(39,827,591)**
Fitimi/ (humbja) operative		**3,422,482**	**22,196,264**
Të ardhura financiare	24	1,057,340	393,223
Shpenzime financiare	24	(1,073,855)	(1,233,113)
Shpenzime financiare neto		**(16,515)**	**(839,890)**
Humbja përpara taksave		**3,405,967**	**21,356,374**
Shpenzim Tatim fitimi		(1,575,808)	(2,636,434)
Humbja e vitit ushtrimor		**1,830,160**	**18,719,939**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		**(263,433)**	**1,513,463**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		**1,566,726**	**20,233,402**

Pasqyra e Fitim humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese pjesë përbërëse të pasqyrave financiare nga faqja 7 deri 58 .

ADMINSTRATORI

Adrian ÇELA

DREJTORI EKONOMIK

Ceno KLOSI

OSHEE SH.A - OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE OSHEE, S. Protokolli Nr. 007

OSHEE SH.A
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(Shumat janë shprehur në000/ lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

	2017	2016
Flukse monetare nga aktiviteti operativ		
Fitim përpara tatimit	3,405,967	21,356,374
Rregullime për:		
Shpenzim për zhvlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale	-	826,969
Korrigjime kontabël të viteve të mëparëshme	758,307	-
Kamatëvonesa të shuara me kompensim	(109,899)	-115
Rregullime për tatimin mbi fitimin	(400,000)	(5,292)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	2,528,909	1,835,305
Të ardhura nga interesi	-22,058	-78,882
Shpenzime interesi dhe pagesa për garanci bankare	538,192	746,797
Shpenzim/(rimarrje) për zhvlerësimin e inventarit	141,437	110,951
Rimarrje e zhvlerësimit për të arkëtueshmet nga klientët	29,197	-8,331,410
Rimarrje e provizioneve për çështje ligjore	-	-
Shpenzime për provizione	1,930,280	237,748
Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimeve te huave	(702,152)	(87,950)
Ndryshimet në:		
- Të arkëtueshme nga klientë	-445,648	-4,953,658
- Inventarë	-1,716,528	-2,115,989
- Aktive të tjera	-5,881,253	8,391
- Llogari të ngurtësuara	3,024,985	-1,549,816
- Të pagueshme tregtare dhe të tjera	26,490,221	3,230,452
- Detyrime për taksat dhe sigurime shoqërore	-5,522,945	1,651,898
- Provizione	-4,569,416	-1,092,262
- Detyrime të tjera	-7,012,067	14,159
	12,465,529	**11,803,669**
Tatim fitimi paguar	-1,007,000	-1,300,000
Interes i paguar	-48,853	-82,525
Pagesa për garancitë	-269,252	-347,556
Interesi i arkëtuar	22,058	78,882
Flukset monetare neto nga aktiviteti operativ	**11,162,483**	**10,152,471**
Flukse monetare nga aktiviteti investues		
Blerje të aktiveve afatgjatë materiale	-11,741,970	-9,400,996
Blerje të aktiveve afatgjatë jo materiale	-483,284	-209,694
Shitje e aktiveve afatgjatë materiale	0	15,753
Aktive financiare	146	629
Flukset monetare neto përdorur në aktivitetin investues	**-12,225,108**	**-9,594,308**
Flukset monetare nga aktiviteti financues		
Hua të marra	4,418,580	999,805
Pagesa për huatë	-3,637,240	(3,074,506)
Flukset monetare neto përdorur në aktivitetin financues	**781,340**	**(2,074,701)**
Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimeve te huave	702,152	87,950
(Ulja)/rritja neto në mjete monetare dhe ekuivalentë me to	420,866	(1,428,588)
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to më 1 janar	1,289,996	2,718,584
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to më 31 dhjetor	**1,710,861**	**1,289,996**

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese pjesë përbërëse të pasqyrave financiare nga faqja 7 deri 58 .

ADMINSTRATORI
Adrian ÇELA

OSHEE SH.A. - OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
OSHEE sh.a.
Protokolli
Nr. 001

DREJTORI EKONOMIK
Ceno KLOSI

OSHEE SH.A

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(Shumat janë shprehur në000/ lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva të tjera	Humbje të akumuluara	Totali i kapitalit aksionar
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	**30,099,102**	**-**	**2,916,011**	**(88,770,268)**	**(55,755,155)**
Pakesim Kapitali	(15,753)			-	(15,753)
Rivlerësim Asete	-	1,513,463	-	-	1,513,463
Të ardhura të tjera 2016	-			18,719,939	17,837,523
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	**30,083,349**	**1,513,463**	**2,916,011**	**(70,050,329)**	**(35,537,506)**
Pakesim Kapitali	-			494,874	494,874
Rivlerësim Asete	-	-263,433	-	263,433	-
Të ardhura të tjera 2017	-			1,830,160	1,830,160
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	**30,083,349**	**1,250,030**	**2,916,011**	**(67,461,863)**	**(33,212,472)**

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese pjesë përbërëse të pasqyrave financiare nga faqja 7 deri 58 .

ADMINSTRATORI

Adrian ÇELA

OSHEE, sh.a. Protokolli Nr. 001

DREJTORI EKONOMIK

Ceno KLOSI

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. Informacion i Përgjithshëm

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (ose "Shoqëria") ka objekt te aktivitetit ofrimin e energjisë elektrike nëpërmjet rrjetit të saj të shpërndarjes për klientët fundor me tarifa të rregulluara.

Shoqëria gjatë vitit 2017, ka qenë e organizuar në Departamentet si vijon:

Divizioni Tregtar (DT), Divizioni i Shpërndarjes (DSH) dhe Divizioni i Administrimit të Përgjithshëm (DAP). Departamenti Ekonomik është pjesë e strukturës së DAP.

Gjithashtu Shoqëria përbëhet nga 11 Drejtori Rajonale që administrojnë shpërndarjen në TM e TU, shitjen dhe arkëtimin e energjise elektrike, si dhe nga Drejtoia e Tensionit Lartë me 4 Drejtori Rajonale të Tensionit të Lartë (DTL).

Shoqëria u krijua si shoqëri Aksionere më 19 Qershor 2007, duke u bazuar në Vendimin nr. 862 të Këshillit të Ministrave, të datës 20 Dhjetor 2006. Kjo Shoqëri u themelua si rezultat i ndarjes nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a ("KESH" ose "Shoqeria Mëmë") dhe filloi aktivitetin e saj operativ që prej 1 Janarit 2007.

Më 29 Maj 2009, 76% të aksioneve të Shoqërisë kaluan në pronësi të shoqërisë CEZ a.s, me seli në Duhova 2/1444, 14074, 4 Pragë, Republika Çeke ndërsa 24% të aksioneve mbetën në pronësi të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Në 21 Janar 2013, Shoqëria u vendos në administrim të përkohshëm nga shteti, me vendim të ERE Nr.4 datë 21.01.2013 " Mbi heqjen e licencës së shpërndarjes së energjisë Shoqërisë".

Me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE, nr.63 dt.17.07.2014 dhe rregjistrimin e tij në QKR, Shoqerisë ju ndryshua emri i rregjistruar duke filluar nga data 23.07.2014, nga Cez Shperndarje sha në Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sha.

Me Ligjin nr.114/2014 dt.31.07.2014, është miratuar marrëveshja për zgjidhjen me mirkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë CEZ AS. Është vendosur transferimi i aksioneve nga CEZ AS shtetit shqiptar, anullimi i të ardhurave të arkëtueshme (detyrimeve) dhe shuma e zgjidhjes me pajtim (detyrimi i ri ndaj CEZ AS).

Bordi i Komisionerëve të ERE, me vendim nr.98 dt.27.10.2014, ka vendosur përfundimin i administrimit të përkohshëm i Shoqërisë.

Më datën 23.10.2014, Ministri i MZHETS, me cilësinë e Aksionarit të vetëm, me Urdhërin nr.454, ka urdhëruar rregjistrimin e 100 % të aksioneve të Shoqërisë në pronësi të shtetit.

Shoqëria ka Statusin e saj, ku është përcaktuar vedndimmarrja dhe drejtimi sipas sitemit me dy nivele. Organet drejtuese janë : Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikqyrës dhe Administratori.

Këshilli Mbikqyrës me Vendimin nr.1 dt.28.10.2014, ka vendosur Z. Ilir Bejtja Kryetar të këtij këshilli.

Shoqëria, nga 1 Dhjetori 2014, ka Administrator z.Adrian Çela. Në datat 5-28.6.2017, Administrator ishte z.Haki Mustafa.

Me vendimin nr.28 datë 28.06.2017, Këshilli Mbikqyrës ka emëruar z.Adrian Çela Administrator të shoqërisë OSHEE sha.

Duke filluar nga data 6 Qershor 2016, aksionet e shoqërisë janë rregjitruar në pronësi të Ministrisë Energjisë dhe Industrisë, sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si përfaqësuese e pronarit shtet, transferuar kështu nga ish aksionari Ministria e Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjitikës.

Shoqëria e ka vendndodhjen në Shqipëri. Adresa kryesore e shoqërisë nga muaji Gusht 2017 është në : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88,H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë. (adresa e regjistruar në QKR).

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kryesore të kontabilitetit të aplikueshme në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë përcaktuar më poshtë.

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të cilat janë lëshuar nga Bordi i Standardeve të Kontabilitetit (BSNK).

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përvec rasteve kur SNRF kërkon baza të tjera matjeje, sic janë përmendur në politikat kontabël më poshtë.

- Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), janë në fuqi për periudhën raportuese:
- Ndryshime në SNK 7 " Pasqyra e Levizjes së Parasë"- Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive per periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- Ndryshime në SNK 12 "Tatimi mbi të Ardhurat" - Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuara (efektive per periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- Ndryshime në SNRF 12 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)" rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje per të eliminuar mospërputhjet dhe per të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do të jenë të aplikueshme per periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017).

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të kompanisë.

2.2 Ndryshimet në politikat kontabël

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emetuar por nuk janë ende efektive:

- SNRF 9 "Instrumentet financiare" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 Janar 2018),
- SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët" dhe ndryshime të mëtejshme (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018),
- SNRF 16 "Qiratë" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2019),
- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat bazuar në Aksione", - Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave me bazë aksionet (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018),
- Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" - Aplikimi i SNRF 9 "Instrumentat financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, ose kur SNRF 9 "Instrumentat financiarë", është aplikuar për herë të parë),
- Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentat Financiarë" - Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),
- Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" - Shitja apo Kontributi i aseteve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të jetë përfunduar),
- Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"- interesa afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),
- Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Materiale Afatgjata të Investuara" - Transferimet e aktiveve materiale afatgjata te investuara (efektive më ose pas 1 janarit 2018),
- Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)" rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 12, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje per të eliminuar mospërputhjet dhe per të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 1 dhe SNK 28 do të jenë të aplikueshme per periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2018).
- Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikli 2015-2017)" që rezultojnë nga përmirësimi i përvitshëm të projektit të SNRF (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllimin që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (efektiv në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019),
- KIRFN 22 "Transaksionet valutë dhe Konsiderata për avancat" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat" efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetesimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

2.3 Vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare, në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, kërkon nga menaxhimi, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve si dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara në datën e raportimit të pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve të

raportuara. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve. Shpjegimi i supozimeve kyçe është përfshirë në seksionet përkatëse të shënimeve, aty ku janë përshkruar vlerësimet domethënëse.

2.4 Këmbimi i valutës së huaj

(a) Monedha funksionale dhe ajo e raportimit

Pasqyrat financiare janë paraqitur në LEK e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë. I gjithë informacioni financiar i pasqyruar në LEK është i përafruar në të mijtën më të afërt (nëse nuk është shprehur ndryshe).

(b) Kursi i këmbimit valutor në fund të periudhës raportuese:

Monedha	Më 31 Dhjetor 7	Më 31 Dhjetor 6
LEKË për 1 EUR	132.95	135.23
LEKË për 1 USD	111.10	128.17
LEKË për 1 CHF	113.94	126.05
LEKË për 100 YEN	0.9874	109.75
LEKË për 1 KRW	0.104	0.1067
LEKË për 1 SDR	157.84	171.76
LEKË për 1 GBP	149.95	157.56

2.5 Aktivet Afatgjata Materiale

Toka dhe ndërtesat, përfshijnë përgjithësisht nënstacione, kabinat elektrike dhe ndërtesa administrative për zyra. Të gjitha Aktivet Afatgjata Materiale (AAM) janë shfaqur me kosto historike (ashtu siç parashikohet në paragrafin e mëposhtëm) minus zhvlerësimet dhe rëniet në vlerë, përvec tokës, e cila shfaqet me kosto minus rënien në vlerë. Kostot përfshijnë shpenzime që lidhen direkt me blerjen e aktivit.

Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë, përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër të lidhur direkt me transformimin e aktivit në kushte pune për qëllimin e tij të caktuar si dhe kostot e çmontimit dhe largimit të aktivit dhe kthimin e zonës ku ka qenë vendosur aktivi në gjëndjen e mëparshme. Çdo blerje programesh kompjuterike që është pjesë e pandashme e veprimtarisë së pajisjes është kapitalizuar si pjesë e kësaj pajisjeje.

Në 1 Janar 2007, AAM të Shoqërisë u ndanë nga aktivet e KESH sh.a. Këto AAM që u ndanë, u regjistruan me një vlerë të bazuar mbi vlerën e mbartur të aktiveve në pasqyrat financiare të KESH më 31 Dhjetor 2006. Shoqëria mëmë ka zgjedhur të vlerësojë një pjesë të konsiderueshme të AAM-ve të veta përgjatë kalimit të saj.

Kostoja e zëvëndësimit të një pjese të AAM, njihet në vlerën e mbetur të AAM, vetëm nëse është e mundshme që përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me këtë pjesë të zëvendësuar do të rrjedhin në Shoqëri si dhe nqs kostoja e saj mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Kostot ditore të mirëmbajtjes dhe të tjera të lidhura me AAM, do të njihen në shpenzimet e periudhës përkatëse që ato ndodhin.

Kostoja e mirëmbajtjes, riparimit dhe zëvendësimit të njësive jo të rëndësishme të AAM regjistrohet si shpenzim mirëmbajtjeje nëperiudhën kur ndodh. Rinovimet dhe përmirësimet kapitalizohen. Kur kryhet

shitja, nxjerrja jashtë përdorimit ose zëvëndësimi i njëpjese të AAM, kostoja dhe zhvlerësimi i akumuluar përkatës i zërit të nxjerrë jashtë përdorimit ose pjesës së zëvendësuar eleminohen nga llogaritë. Fitimi ose humbja që mund të rezultojë regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave.

Në çdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka ndonjë indikacion që ndonjë aktiv mund të ketë pësuar rënie në vlerë (të jetë zhvlerësuar). Kur një indikator i tillë ekziston, Shoqëria rishikon shumat e rikuperueshme të aktiveve të saj afatgjata materiale, për të përcaktuar nëse këto shuma vazhdojnë tëtejkalojnë vlerat e mbartura të aktiveve. Zhvlerësimi i identifikuar i aktiveve afatgjata materiale njihet direkt nëpasqyrën e të ardhurave, në zërin e shpenzimeve të tjera operative.

Zhvlerësimi

Shoqëria zhvlerëson koston fillestare të AAM, minus vlerën e rikuperueshme, duke përdorur metodën lineare të zhvlerësimit përgjatë jetës ekonomike të vlerësuar. Çdo pjesë e njësisë së AAM me një kosto që është domethënëse, në lidhje me koston totale të njësisë, zhvlerësohet veçmas. Tabela e mëposhtme shfaq kohën e përdorimit të vlerësuar të aktiveve:

Emërtimi i asetit	Jetëgjatësia
Softëare	2 - 5 vjet
Licensa	3 - 5 vjet
Ndërtesa	1 - 80 vjet
Makinerin e paisje	1 - 44 vjet
Mjete transporti	1 - 11 vjet
Paisje zyre dhe informatike	1 - 20 vjet

Vlera e mbetur e aktiveve, jetëgjatësia dhe metodat e zhvlerësimit janë rishikuar, rregulluar aty ku është e nevojshme.

2.6 Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlerat e mbartura e aktiveve jo-financiare të Shoqërise, përvec inventarëve dhe aktivit të shtyrë tatimor, do të rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë indikacion për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë indikacion i tillë, vlera e përfitueshme e aktivit duhet të vlerësohet. Humbja nga rënia në vlerë e aktivit njihet kur vlera e mbartur është më e lartë se vlera e tij e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë e aktiveve njihen në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e lartë e vlerës në përdorim të tij ose vlerës së drejtë të aktivit minus kostot e shitjes. Kur bëhet vlerësimi i vlerës në përdorim të aktivit, flukset e ardhshme të vlerësuara monetare, skontohen në vlerën e tyre të tanishme, duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin e tanishëm të tregut të vlerës së parasë dhe të riskut specifik të aktivit.

Humbjet nga rënia në vlerë, të njohura nëperiudhat e mëparshme, vlerësohen në cdo datë raportimi për cdo indikacion të mundshëm nëse humbja është rritur apo nuk ekziston më. Një humbje nga rënia në vlerë,rikthehet nëse ka ndryshime në vlerësimet e bëra për përcaktimin e vlerës së përfitueshme. Një humbje nga rënia në vlerë kthehet deri në vlerën që vlera e mbartur e aktivit nuk kalon vlerën e mbetur që do përcaktohej, neto nga zhvlerësimet dhe amortizimet, nëse humbja nga rënia në vlerë e aktivit nuk do të njihej.

2.7 Rënia në vlerë e aktiveve financiare

Një aktiv financiar do të konsiderohet i zhvlerësuar në rastin kur ekzistojnë fakte të dukshme që një ose disa ngjarje kanë patur efekt negativ mbi fluksin pritshëm monëtar të vlerësuar.

Një humbje nga zhvlerësimi i aktiveve financiare, i matur me koston e amortizimit, përllogaritet si diferencë midis vlerës ekzistuese dhe vlerës aktuale të fluksit të ardhshëm të parave të aktualizuar me normën fillestare efektive tëInteresit.

Aktivet financiare të rendësishme testohen për zhvlerësim në bazë individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet në grup, për grupe që ndajnë karaktëristika të ngjashme risku.

Një zhvlerësim i aktivit mund të jetë i kthyeshëm në rast se ky kthim mund të lidhet me një ngjarje objektive e cila ndodh pas njohjes së zhvlerësimit të aktivit. Për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar, kthimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.8 Inventarët

Inventarët vlerësohen me vlerën më të vogël mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarit përfshin shpenzimet e njohura gjatë blerjes së inventarit, prodhimit ose kostos së tjetërsimit dhe kostove të tjera shtesë të njohura për ruajtjen dhe sjelljen në pozicionin ekzistues të inventarit. Në rastin e inventarit të prodhuar dhe prodhimit në proces kostot përfshijnë një marzh të kostove shtesë prodhuese, bazuar në operimin me kapacitet normal.Vlera neto e realizueshme është ekuivalente me diferencën e cmimit të shitjes së parashikuar, në rastin e një veprimtarie normale të biznesit me kostot totale të parashikuara dhe shpenzimet e shitjes.

2.9 Instrumentat financiare

Shoqëria zotëron vetëm instrumenta financiare jo - derivativë duke përfshirë llogaritë e arkëtueshme nga shitjet dhe llogari të tjera të Arkëtueshme, para dhe ekuivalentet e saj, kredi dhe hua, si edhe llogari të pagueshme e detyrime të tjera.

Instrumentat financiare jo-derivativë vlerësohen fillimisht më vlerën e tyre të drejtë plus, për instrumentë jo të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e tjera të transaksionit. Pas njohjes fillestare këto instrumenta jo- derivativë maten si më poshtë:

Një instrument financiar njihet në momentin kur shoqëria bëhet pjesë e dispozitave kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare nuk njihen nqs të drejtat kontraktuale tëshoqërisë mbarojnë ose ndërpriten ose nëse shoqëria transferon aktivin financiar një pale tjetër pa patur kontroll ose të gjitha risqet dhe shpërblimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet e zakonshme të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit, dmth datën që shoqëria merr përsipër të blejë apo të shesë aktivin.

Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuar në kontratë mbarojnë ose anullohen.

Aktivet monetare dhe ekuivalentë të tjerë

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë para në dorë, depozitat e lira në banka dhe investime të tjera

afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturitet fillestar prej tre muajsh ose më pak.

Llogaritë e Arkëtueshme

Të drejtat ndaj të tretëve njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me diferencën e kostos së amortizuar me humbjet nga zhvlerësimi.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme fillimisht regjistrohen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar.

Kreditë dhe Huamarrjet

Pas njohjes fillestare, kreditë dhe huatë njihen me kosto të amortizuar me ndonjë diferencë midis kostos dhe vlerës se shlyerjes duke u njohur në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës së huamarrjes.

Të tjera

Instrumentet e tjera financiare jo-derivativë maten si diferencë e kostos së amortizuar, duke përdorur metodën efektive të interesit, me humbjet nga rënia në vlerë (zhvlerësimi).

Vlera e drejtë e të drejtave ndaj të tretëve, duke përjashtuar punën e prodhimit në proces, është vlerësuar si vlerë aktuale të fluksit të ardhshëm të parasë aktualizuar me normën e interesit të tregut në datën e raportimit.

Instrumentet financiare janë të klasifikuara si detyrime aktuale vetëm nëse shoqëria ka të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë zgjidhjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

2.10 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga Interesi mbi gjëndjen e fondeve në bankë dhe fitimet nga kursi i kembimit i njohur në Pasqyrën e të Ardhurave. Të ardhurat nga Interesi njihen në vazhdimësi.

Shpenzimet financiare përbëhen nga shpenzimi i interesit të huave si dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

2.11 Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë i të ardhurave

Shpenzimet tatimore përbëhen nga tatimi aktual dhe ai i shtyrë. Shpenzimet tatimore njihen në Pasqyrën e të Ardhurave, përveçse kur lidhen me zëra të njohur drejtpërdrejtë në kapital dhe në një rast të tillë ato njihen si pjesë kapitali.

Manaxhimi vlerëson në mënyrë periodike pozicionet e marra në deklarimet e tatimit mbi fitimin, duke marrë parasysh situatat në të cilat rregulloret e aplikueshme tatimore janë subjekt i interpretimeve dhe aty ku është e përshtatshme, krijon Provigjionet përkatëse.

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose të miratuara në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke marrë parasysh diferenca të përkohshme ndërmjet vlerësneto kontabël në bilanc të një aktivi ose pasivi për qëllime të raportimit financiar dhe bazës se tij tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen në diferencat e përkohshme, kur ato të kthehen mbrapsht, në bazë të ligjeve që janë nxjerrë ose miratuar në datën e raportimit.

2.12 Përfitimet e punonjësve

(a) Fondet për pension, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore
Shoqëria është e detyruar nga legjislacioni aktual shqiptar për të derdhur kontribute fikse në emër të të punësuarve në një fond për sigurim shoqëror tëpërcaktuar nga Qeveria. Të gjitha këto pagesa / detyrime njihen si shpenzime në periudhën me të cilen ato lidhen.

(b) Përfitimet pas ndërprerjes së punës
Në përputhje me Kontratën e punës kolektive, në rast të përfundimit të një kontrate pune pasi punonjësi ka arritur moshën e nevojshme në bazë të ligjit për dalje në pension, pavarësisht nga arsyeja për ndërprerjen e punës, punonjësi ka të drejtë për një kompensim prej dy pagash mujore bruto.

Përfitimet e ndërprerjes së punës njihen si shpenzime kur shoqëria i është nënshtruar, pa mundësi reale për t'u tërhequr, një plani të detajuar zyrtar për ndërprerjen e punësimit para datës së daljes në pension ose për të siguruar përfitime për ndërprerje të marrëdhënies së punës si rezultat i një oferteqë mund ti bëhet punonjësit për largim vullnetar. Përfitimet pas ndërprerjes së punës për largime vullnetare njihen si një shpenzim në qoftë se shoqëria bën një ofertë inkurajuese për largim vullnetar, është e mundur që kjo ofertë të pranohet dhe numri i pranimeve mund të vlerësohet lehtësisht.

2.13 Provigjionimi

Provigjionimi njihet nëse, si rezultat i një ngjarje të kaluar, shoqëria ka një detyrim ligjor aktual ose të ardhshëm që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që një pjesë e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provigjionet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të ardhshme të parave me normën e interesit para - tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe risqet specifike që lidhen me atë detyrim.

2.14 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë fluksi bruto i përfitimeve ekonomike gjatë periudhës aktuale dhe normale të aktivitetit të një njësie ekonomike kur ato flukse rezultojnë në rritje në kapital, përveç rritjeve të kontributeve nga pjesëmarrësit e kapitalit. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të konsideruar dhe pranuar si të arkëtueshme për shitjen e mallrave dhe shërbimeve gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë së kompanisë. Të ardhurat janë të njohura neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, kthimet, rimbursimet dhe zbritjet.
Shoqëria i njeh të ardhurat në bazë të faturave të lëshuara për energjinë e furnizuar, kur shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që njësia do të marrë përfitimet e ardhshme ekonomike. Shuma e të ardhurave nuk mund të konsiderohet e matshme me besueshmëri, derisa të gjithë detyrimet e kushtëzuara që kanë të bëjnë me shitjen të jenë zgjidhur. Shoqëria bazon vlerësimet e saj mbi rezultatet historike, duke marrë parasysh llojin e konsumatorit, llojin e transaksionit dhe specifikat e çdo marrëveshjeje.

(a) Shitjet e energjisë elektrike

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike përbëjnë vlerën e faturuar të energjisë elektrike të furnizuar. Faturimet e energjisë elektrike bëhen në baza mujore.

(b) Të ardhura të tjera

Të ardhurat mbi shërbimet e ofruara klientëve si p.sh. Lidhje e re, ndryshimi i emrit në kontratë, verifikimi i matësit,etj. janë të njohura kur shërbimi ofrohet. Këto të ardhura, sëbashku me të ardhurat nga kamatëvonesat për pagesat me vonesë, janë të përfshira në të ardhura të tjera.

2.15 Qiratë

Kontratat e qirave në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve nga pronësia janë të mbajtura nga qiradhënësi, janë klasifikuar si qira operative. Pagesat e bëra nën zërin e qirave operative (neto duke i zbritur të gjithë stimujt e marrë nga qeramarrësi), futen në pasqyrën e të ardhurave me bazë lineare gjatë gjithë periudhës së qirasë.

2.16 Grantet qeveritare dhe grante të tjera

Grantet e tjera (dhurime asetesh) janë njohur si të ardhura në Pasqyrën e të Ardhurave në mënyrë sistematike në të njëjtën periudhë në të cilën shpenzimet janë njohur.

3. Menaxhimi i riskut financiar

Funksioni i Menaxhimit të riskut në kompani është kryer në lidhje me rreziqet financiare (rreziku i kredisë, i tregut, i kursit të këmbimit, i likuiditetit dhe i normave të interesit), rreziqet operacionale (të tilla si rrezik për mjedisin) dhe rreziqe ligjore. Objektivat kryesore të funksionit të menaxhimit financiar të rrezikut janë vendosur për të përcaktuar kufijtë e rrezikut e më pas të sigurojnë qëndrimin brënda këtyre kufijve të ekspozimit ndaj rreziqeve. Manaxhimi operacional e ligjor ka për qëllim të sigurojë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për të minimizuar risqet operacionale e ligjore.

3.1 Risku i kredisë

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, i cili është rreziku që një palë në instrumentin financiar, do të shkaktojë një humbje financiare për palën tjetër, duke mos arritur që të shlyhet detyrimi. Ekspozimi kryesor i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë lind për shkak të drejtave ndaj të tretëve. Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj riskut të kredisë korrespondon me shumat e mbartura të aktiveve financiare në bilanc. Impakti i kompensimit të mundshëm të aktiveve dhe detyrimeve për të reduktuar ekspozimin ndaj riskut të kreditit, nuk është domethënës.

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	4,135,776	6,739,895
Llogari te arketueshme tregtare, neto	20,932,065	20,515,613
Te tjera te arketueshme (përjashtuar parapagimet)	686,271	278,654
Aktive financiare	1,461	1,607
Totali i ekspozimit ndaj rezikut te kredise	**25,755,573**	**27,535,769**

Maksimumi i ekspozimit ndaj rezikut te kredisë per kërkesat per arkëtim sipas kategorisë se klientit eshte si vijon:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Buxhetore	321,839.00	263,794
Familjare	15,289,015.00	15,723,463
Jo-Buxhetore	987,038.00	843,271
Private	4,334,173.00	3,685,085
Total	**20,932,065**	**20,515,613**

3.1.1 Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit në veprimtarinë e saj të përditshme, sepse është e mundur që klientët e saj si dhe huamarrësit do të dështojnë të përmbushin detyrimet e tyre financiare. Strukturat e Kompanisë, nivelet e rrezikut të kredisë që merr përsipër, duke vendosur kufizime në sasinë e rrezikut të pranuar në lidhje me palë të treta dhe nëpërmjet diversifikimit të portofolit të kredisë, janë metoda në manaxhimin e riskut. Rreziqet e tilla janë të monitoruara në një bazë të ndryshueshme dhe i nënshtrohen një analizë vjetore ose dhe më të shpeshtë.

3.1.2 Përqëndrimi i rrezikut të kredisë

Shoqëria është e ekspozuar ndaj përqëndrimeve të rrezikut të kredisë. Menaxhimi monitoron përqëndrimin e rrezikut të kredive, por has vështirësi në zbatimin e politikave më të mira të menaxhimit të ekspozimit të kompanisë ndaj rrezikut të tillë, duke diversifikuar portofolin e kredisë. Kjo ndodh për shkak se shoqëria është e detyruar të furnizojë me energji konsumatorin fundor. Në kushte të tilla, diversifikimi është i vështirë për t`u aplikuar. Në rastin e shitjes së energjisë, rreziqet e kompanisë ekzistojnë në mospërmbushjen e objektivave të saj, për një ose më shumë nga arsyet e mëposhtme: a) konsumatorët refuzojnë të paguajnë faturat e tyre, b) konsumatorët ndërhyjnë apo shkëpusin matësat. Depozitat bankare të kompanisë mbahen në banka të ndryshme.

3.2 Risku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes që rezulton nga ndryshimet në çmimet e tregut vendas (tarifave të transmisionit të energjisë), normat e këmbimit valutor si dhe normat e interesit. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit shoqëria është e ekspozuar në një moment në kohë ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritjet e çmimeve në të ardhmen apo lëvizjet e kursit të tregut dhe përbërjen e aktiveve të kompanisë dhe të portofolit të kontratës.

Menaxhimi përcakton kufijtë për vlerën e rrezikut që mund të pranohet, të cilët monitorohen në baza mujore.

3.2.1 Risku nga këmbimi valutor

Risku nga kursi i këmbimit vjen nga fakti se pjesa më e madhe e kredive të saj e një pjesë e të pagueshmeve si dhe një pjesë e të arkëtueshmeve të shoqërise janë në valutë. Risku shkaktohet nga fakti se vlera e monedhës funksionale do të ndryshojë duke qenë se flukset e parave që dalin nga shlyerja e huave e Interesave të lidhura me to dhe të pagueshmeve të tjera, do të ndryshojnë si rezultat i lëvizjeve në kursin e këmbimit, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në fitimin e kompanisë. Po kështu ndikim do të ketë edhe nga gjendjet e valutave në banka dhe të arkëstueshmet në valutë.

Të dhëna për Të Arkëtueshme dhe Të Pagueshme në valutë, më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016, janë si më poshtë, të shprehura në mijë lekë sipas valutave :

Për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 :

Te Arketueshme/ Te pagueshme	Euro	USD	SDR	KRË	YEN	GBP	Totali
Llogari treg. te arket. dhe te tjera	11,817						11,817
Mjete monetare ne arke dhe banke	1,715,340	524				6	1,715,870
Shuma	**1,727,158**	**524**				**6**	**1,727,687**
Llogari treg. te paguesh. e te tjera	8,898,262	12,055					8,910,317
Huate	8,352,920	1,280,096	759,884	875,421	2,132,401		13,400,722
Shuma	**17,251,183**	**1,292,151**	**759,884**	**875,421**	**2,132,401**		**22,311,039**
Rrisku i kursit Kembimit me 31 Dhjetor 2017	**18,978,340**	**1,292,675**	**759,884**	**875,421**	**2,132,401**	**6**	**24,038,726**

Për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 :

Te Arketueshme/ Te pagueshme	Euro	USD	SDR	KRË	YEN	GBP	Totali
Llogari treg. te arket. dhe te tjera	1,512						1,512
Mjete monetare ne arke dhe banke	3,639,586	513				7	3,640,106
Shuma	**3,641,098**	**513**	**0**	**0**	**0**	**7**	**3,641,618**
Llogari treg. te paguesh. e te tjera	1,136,671	231					1,136,902
Huate	12,133,085	1,472,806	825,676	878,828	2,433,662	0	17,744,057

Shuma	13,269,759	1,473,037	825,676	878,828	2,433,662	0	18,880,959
Rrisku i kursit Kembimit me 31 Dhjetor 2016	16,910,854	1,473,550	825,676	878,828	2,433,662	7	22,522,577

Ekspozimi total është i barabartë me ekspozimin neto për zërat e bilancit në valutë, i shprehur në lekë më 31 Dhjetor 2017, është 24,038,726 mijë lekë.

3.2.2 Risku nga norma e interesit

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria merr hua për të financuar operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës të interesit për shkak se, vlera e drejtë e huasë me normë fikse dhe flukset e lidhura me hua me normë të ndryshueshme, do të sjellin ndryshime në normat e interesit.
Shoqëria nuk ka politika formale dhe procedura në fuqi për menaxhimin e rreziqeve të normës së interesit për aq kohë sa menaxhimi e konsideron këtë rrezik si të parëndësishëm duke qenë se Shoqëria aktualisht zotëron hua me norma Interesi nën normat e tregut.

3.2.3 Risqe të tjera të çmimeve

3.2.3.1 Çmimet e kapitalit

Shoqëria nuk ka ekspozim ndaj riskut të çmimit të kapitalit, për aq kohë sa ajo nuk zotëron aktive financiare të përbërë nga instrumentë të kapitalit. Nuk është në politikën e kompanisë blerja e instrumenteve të tilla dhe në të tilla rrethana, ajo nuk është e ekspozuar nga lëvizjet e çmimeve në tregun e kapitalit.

3.2.3.2 Çmimet e energjisë

Sipas modelit të tregut aktual të energjisë, shoqëria përllogarit një tarifë fikse për njësi të energjisë siç është miratuar nga Enti Shqiptar Rregullator i Energjisë. Sipas kuadrit legjislativ, parashikohet që shoqëria të përballojë shpenzimet që vijnë në formën e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, si dhe blerjen dhe shitjen e energjisë së balancuar, e cila është sasia e energjisë së nevojshme për të mbushur hendekun midis konsumit dhe furnizimit të energjisë në një periudhë të caktuar të ditës. Çmimi i energjisë elektrike në tregjet vendase dhe ndërkombëtare është i rëndësishëm për kompaninë në rrethana të tilla të reja.
Çmimet e energjisë që Shoqëria do të mund të aplikojë në lidhje me energjinë e blerë dhe të shitur, janë subjekt i miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri, gjë që sjellë një risk të çmimeve.
Enti Rregullator i Energjisë ka miratuar çmimet e shitjes së energjisë për vitin 2015 dhe ato nuk kanë ndryshuar në vitet 2016-2017.

3.3 Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është përcaktuar si risku që një njësi ekonomike do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me shlyerjen e detyrimeve financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj kërkesave të përditshme për likuiditet, kryesisht në mënyrë që të mbulojë shpenzimet e saj operative gjatë veprimtarisë normale si dhe për të shlyer borxhet e saj. Nga ana tjetër, shoqëria përballet me vonesa në grumbullimin e të ardhurave për energjinë e sidomos nga konsumatorët individualë. Menaxhimi monitoron me kujdes parashikimet për arkëtimet/pagesat mujore (lëvizjet e flukseve të parave).

Procesi i menaxhimit të likuiditetit të miratuar nga ana e menaxhimit përfshin edhe vendosjen e afateve për shpenzimet e zonave që lidhen me aktivitetet e përditshme si për shërbimet, furnizimet, investimet, shtyrjen e pagesave të kreditorëve të caktuar, apo shtyrjen e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet palëve, duke parashikuar pagesat e borxhit dhe siguruar se ato janë të mbuluara, etj.

Flukset monetare sipas viteve referuar kontratave janë :

Viti 2017	Gjendje	> 1 vit	1-5 vjet	>5 vjet	Total
Llogari tregetare të pagueshme dhe të tjera	72,197,636	72,197,636	-	-	72,197,636
Detyrime te tjera	7,661,495	7,661,495	-	-	7,661,495
Huatë	18,745,485	8,205,076	4,510,993	6,029,416	18,745,485
Total	**98,604,615**	**88,064,206**	**4,510,993**	**6,029,416**	**98,604,615**

Viti 2016	Gjendje	> 1 vit	1-5 vjet	>5 vjet	Total
Llogari tregetare	45,817,313	45,817,313	-	-	45,817,313
të tjera					
Detyrime te tjera	14,673,562	14,673,562	-	-	14,673,562
Huatë	17,744,057	6,997,167	4,817,312	6,887,427	18,701,906
Total	**78,234,932**	**67,488,042**	**4,817,312**	**6,887,427**	**79,192,781**

Të dhënat dhe llogaritja e rriskut korrekt të likujditetit, më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016, janë si më poshtë :

Aktivet/detyrimet Afat Shkurter	Me 31.12.2017	Me 31.12.2016
Inventarët	6,043,898	4,468,808
Llogari tregetare të arketueshme dhe të tjera	27,162,037	20,864,333
Mjete monetare në arkë dhe bankë	1,710,862	1,289,996
Mjete monetare në arkë dhe bankë/ jo Cash	2,424,915	5,449,899
	37,341,712	**32,073,035**
Llogari tregetare të pagueshme dhe të tjera	72,197,636	45,827,058
Taksa, Tatime, Sigurime Shoq. & Shend.	8,283,818	13,637,947
Hua	7,205,076	6,624,743
Të tjera të pagueshme	10,646,151	20,295,821
Rrisku i Likujditetit në fund të periudhës	**0.38**	**0.36**

3.4 Vlerat e drejta

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një instrument financiar mund të shkëmbehet në një transaksion në mes dy palëve të gatshme, përveç se në rastin e një shitjeje të detyruar ose të likuidimit të menjëhershëm, dhe është përcaktuar më së miri nga një çmim tregu.

Vlerat e drejta të instrumentëve financiare

Vlera e drejtë përcaktohet si shuma me të cilën instrumenti mund të shkëmbehet në një transaksion aktual ndërmjet palëve të gatshme, në një transaksion ku palët veprojnë në mënyrë të pavarur (parimi arm's length), përvecse në rastin e një shitjeje të detyruar ose të likuidimit të menjëhershëm.

Vlerat e drejta merren nga çmimet e kuotuara në treg, modelet e skontimit të fluksit të parasë dhe modelet e çmimeve të tregut për produktet, sipas rastit. Metodat dhe supozimet e mëposhtme përdoren për të vlerësuar çmimin e tregut në çdo kategori të instrumenteve financiare:

Aktive monetare dhe ekuivalente të tjerë, investimet afatshkurtra
Vlera e mbartur e parave dhe aktiveve financiare afatshkurtra përafrohet me vlerën e drejtë në bazë të maturimit relativisht afatshkurtër të këtyre instrumenteve financiare.

Llogari të arkëtueshme dhe për t'u paguar
Vlera e mbartur e llogarive të arkëtueshme dhe për t'u paguar përafrohet me vlerën e drejtë në bazë të maturimit relativisht afatshkurtër të këtyre instrumenteve financiare.

Kredi afatshkurtra
Vlera e mbartur përafërohet me vlerën e drejtë për shkak të periudhës së shkurtër të maturitetit të këtyre instrumenteve.

Borxhi afatgjatë
Vlera e drejtë e borxhit afatgjatë bazohet në flukset kontraktuale të skontuara me normat e përshtatshme të tregut. Sasia e mbartur e borxhit afatgjatë dhe llogarive të tjera për t'u pagur me norma të ndryshme Interesi përafrohet me vlerën e tyre të drejtë.

Vlerat e mbartura dhe vlerat e pritshme të drejta të instrumenteve financiare më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016, janë si më poshtë (në mijë lekë):

		2017		2016	
Aktivet /Detyrimi	Kate goria	Vlerat e mbartura	Vlera e drejtë	Vlerat e mbartura	Vlera e drejtë
Aktivet Afat shkurtëra :					
Llogari të Arkëtueshme	KLLA	20,932,065	20,932,065	20,515,613	20,515,613
Aktivet monet. e të tjerë	KLLA	4,135,776	4,135,776	6,739,895	6,739,895
Aktive të tjera afatshk	KLLA	12,273,871	12,273,871	4,817,527	4,817,527
Detyrimet :					
Borxhi afatgjatë	KA	(11,540,409)	(11,540,409)	(11,119,314)	(11,119,314)
Borxhi afatshkurtër	KA	(7,205,076)	(7,205,076)	(6,624,743)	(6,624,743)
Llogaritë e pagueshme	KA	(72,197,636)	(72,197,636)	(45,817,313)	(45,817,313)

Të tjera të pagueshme	KA	(15,945,312)	(15,945,312)	(28,311,509)	(28,311,509)

KLLA Kreditë dhe Llogaritë e Arkëtueshme
KA Detyrimet financiare me koston e amortizimit

3.5 Menaxhimi i Kapitalit

Kur flitet për menaxhimin e kapitalit objektivat e kompanisë janë të tilla për të ruajtur një vazhdueshmëri normale të aktivitetit në mënyrë që të sigurohen fitime për Aksionerët dhe përfitime për palët e Interesuara si edhe për të mbajtur një strukturë optimale kapitali në mënyrë që të reduktohet sa më shumë kosto e kapitalit.
Struktura e kapitalit aksionar nuk ka ndryshuar nga vitit i mëparshëm. Të dhënat për kapitalin aksinar dhe strukturën e tij në fund të periudhës 31 Dhjetor 2017 është si më poshtë :

Gjendja më 31.12.2017

Numeri i Aksioneve	nominale e aksionit	Aksioner :	Struktura Kapitalit regjistruar	Kapitali aksionar - ne leke
30,083,349	1,000	**Totali**		**30,083,349,246**

4. Vlerësimet kritike dhe gjykimet e kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet bëhen në vazhdimësi dhe bazohen në përvoja historike, duke përfshirë ngjarje të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësimet dhe supozimet lidhur me të ardhmen. Vlerësimet e kontabilitetit do të rezultojnë, sipas rastit, pothuajse të barabarta me rezultatet aktuale.

Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një rrezik të konsiderueshëm dhe mund të shkaktojnë një rregullim material në vlerat e aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë diskutuar më poshtë:

4.1 Vlerësime dhe supozime kritike kontabël

(a) Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Vlera e drejtë e instrumentave financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (për shembull, hua të marra ose të dhëna punonjësve) përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të zgjedhur një numër metodash dhe bën supozime që bazohen kryesisht në kushtet e tregut në çdo datë bilanci. Shoqëria përdor metodën e skontimit të fluksit të mjeteve monetare për aktive dhe detyrime financiare që nuk tregtohen në tregje aktive.

(b) Aktivet afatgjata materiale

Drejtimi i shoqërisë përcakton jetën e dobishme të pritur të përdorimit dhe normat e zhvlerësimit, në lidhje me aktivet afatgjata që ka në zotërim. Ky vlerësim bazohet në ciklet e përcaktuara të jetës së aktivit. Kjo mund të ndryshojë në varësi të ndryshimeve të mundshme në treg. Ndryshimet e mundshme në jetëgjatësinë e përdorimit të aktivit mund të çojnë në axhustime të vlerës së tyre neto.

(c) Rënie në vlerë e aktiveve financiare (hua dhe llogari të Arkëtueshme)

Shoqëria ndjek udhëzimet e SNK-ve për të përcaktuar se kur një aktiv financiar ka pësuar rënie në vlerë. Ky përcaktim kërkon gjykim të thellë. Gjatë kryerjes së këtyre gjykimeve, Shoqëria vlerëson, veç faktorëve të tjerë, kohëzgjatjen dhe shtrirjen gjatë të cilës vlera e drejtë e një investimi,është më e vogël se kostoja e tij dhe flukset e veta të mjeteve monetare.

Rigjykimi i rënies në vlerë, të llogarive të Arkëtueshme në vitin pasardhës, mund të çojnë në korigjime të vlerës së mbartur të llogarisë së arkëtueshme.

4.2 Gjykimet në lidhje me Parimin e vijimësisë

Pasqyrat financiare 2017 janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e OSHEE do të ketë vijimësi, në përputhje me përshkrimet e zbatimit të këtij parimi në Standartin Ndërkombetar të Kontabilitetit (SNK) Nr.1 Paragrafi 25.

Siguria në vijimësinë e aktivitetit të shoqërisë në vitin 2017 dhe në vazhdim mbështetet në:

a. Pozita e favorshme në tregun e energjisë.

OSHEE vazhdon të ruajë pozitë të favorshme në tregun e energjisë, pozitë e cila për periudhën në vazhdim sanksionohet edhe në ligjin Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë" datë 30.04.2015 i cili parashikon vazhdimin e aktivitetit të Operatorit të Shpërndarjes aksionet e të cilit zotërohen tërësisht nga shteti dhe për të cilin nuk ka plane afatshkurtëra dhe afatmesme privatizimi.

Bazuar në ligjin Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë", ishte parashikuar, se aktivitetit i shitjes së energjisë do të ndahej nga ai i shpërndarjes deri në datën 31.12.2017 por ky proces ka filluar te implementohet në fillim të vitit 2018 me objektivin për të përfunduar ndarjen deri në fund të vitit tatimor 2018. Hapja e tregut dhe humbja e monopolit të OSHEE në aktivitetin e shitjes së energjisë do të bëhet hap pas hapi në përmbushje të kërkesave të ligjit dhe do të kërkojë një periudhë të paktën disavjeçare pas vitit në vazhdim 2018.

b. Rezultati ekonomik i aktivitetit dhe përmirësimi i pozicionit financiar të OSHEE

Aktiviteti ekonomik i OSHEE ka shënuar përmirësim të jashtëzakonshëm në periudhën 2015 - 2017, duke kaluar nga humbja e vazhdueshme që prej krijimit të shoqërisë në vitin 2007 në rezultat financiar pozitiv që i ka tejkaluar të gjitha pritshmëritë.

Viti që u mbyll 2017 ishte viti i vështirësive të jashtëzakonshme financiare të sistemit energjitik dhe sidomos për OSHEE mbi të cilën rëndoi pjesa më e madhe e pasojave për shkak të faktorëve si më poshtë:

- Për shkak të thatësirës KESH dhe HEC-et lokale nuk mundën të plotësojnë sasinë e planifikuar dhe të kontraktuar në bazë të kontratës së furnizimit dhe OSHEE u detyrua të blejë në tregun e hapur (import) sasinë e nevojshme për mbulimin e nevojave të konsumatorëve. Sasia e energjisë së furnizuar nga KESH dhe HEC-et ishte 1,370 Gëh më e vogël se sa sasia e energjisë që u planifikua në fillim të vitit të cilën OSHEE e bleu në tregun e hapur me çmim mesatar 8.9 Lekë/Këh nga 3 Lekë/Këh që ishte planifikuar.
- Rritja e konsumit të energjisë tej parashikimit detyroi blerjen e energjisë tej planifikimit për 406 Gëh.
- Rritja e çmimit të importit për rreth 38% nga 6.42 Lekë/Këh në 8.9 Lekë/Këh.

Si rrezultat i faktorëve të mësipërm OSHEE u detyrua të shpenzonte për blerjen e energjisë dhe transmetimin 14.2 Miliard Lekë më shumë se sa shpenzimi i planifikuar ose rreth 106.7 Milion EURO. Si rezultat i rritjes së jashtëzakonshme të shpenzimeve për energji OSHEE do të mbyllë vitin financiar 2017 me humbje prej rreth 1.2 miliard Lekë.

Ndikimi negativ i Rritjes së shpenzimeve të blerjes së energjisë në rezultatin e vitit 2017 u zvogëlua nëpërmjet masave të marra në përmirësim të treguesve ekonomiko financiare, të cilat synojnë:

- Zvogëlim i humbjeve jo-teknike nëpërmjet forcimit të kontrolleve në rrjet, ndërprerjes së lidhjeve të paligjshme dhe vendosjes para ligjit të abuzuesve si dhe nëpërmjet investimeve që përmirësojnë teknollogjinë dhe organizimin e punës.
- Zvogëlimin e humbjeve teknike nëpërmjet rritjes së efiçiencës së rrjetit nga përmirësimi i mirëmbajtjes dhe investimeve të reja.
- Rritjen e arkëtimit nëpërmjet politikave të ristrukturimit të borxhit dhe përmirësimit të marrdhënieve me klientët duke përmirësuar shërbimin dhe rritur besimin reciprok.
- Rritjes së efiçencës së punës së punonjësve të shoqërisë nëpërmjet masave organizative, rritjes së kualifikimit dhe motivimit të punonjësve.
- Përmirësimit të cilësisë së furnizimit me energji elektrike nëpërmjet investimeve në teknollogji të përparuara që përmirësojnë treguesit teknikë të furnizimit.
- Zvogëlimit të kohës së ndërprerjeve teknollogjike dhe të kohëzgjatjes së riparimit të defekteve në rrjet.

Më poshtë treguesit kryesorë të performancës periudhës 2016 - 2017 si dhe rezultatet paraprake të periudhës Janar - Prill 2018, në milion Lek :

	2016	2017	Jan-Prill 2018
Marzhi bruto	26,143	13,936	7,209
Të ardhura të tjera	1,880	6,773	422
OPEX pa përfshirë amortizimin	-12,934	-12,216	-3,639
Provigjionim edhe rezerva	8,942	-2,652	-507
EBITDA	24,031	5,841	3,130
Fitim Neto	18,720	1,830	1,675

	2016	2017	Jan-Prill 2018
Norma e arkëtimit	91,94%	97.10%	99.18%
Norma e humbjeve	28,04%	26.41%	26.82%

Tarifa e KESH	3,000/1,450	1,450	1,500
Tarifa e OST	650	650	750

Përmirësimi i treguesve të pozicionit financiar të shoqërisë për periudhën 2016 - 2017 paraqitet në tabelën si më poshtë, në milion Lekë :

	2016	2017
Kapitali	(35,537)	(33,212)
Humbjet e mbartura	(70,050)	(67,462)
Aktivet afatgjata	29,884	39,317

c. *Mbështetja e Qeverisë*

Për kalimin e situatës së vështirë të krijuar gjatë vitit 2017 me likuiditetin në OSHEE, ajo u ndihmua nga Qeveria Shqiptare e cila miratoi një kredi afatshkurtër prej 1 miliard Lekë dhe një tjetër afatgjatë prej 1.5 miliard Lekë mbështetur në Aktin Normativ Nr.2 datë 16.08.2017 si dhe në VKM Nr.539 datë 09.10.2017.

Menaxhimi i shoqërisë i ka kërkuar mbështetjen e Qeverisë Shqiptare për përfshirje më të madhe të Shoqërisë në Ligjin për amnistinë fiskale që u zbatua gjatë vitit 2017 nga i cili OSHEE përfitoi një shumë rreth 5.4 miliard Lekë.

Qeveria ka aprovuar në Shkurt 2015 Planin për Rimëkëmbjen Financiare në Sektorin e Energjisë, me synimin për të përmirësuar arkëtimet, flukset monetare, pakësuar humbjet dhe siguruar furnizim të qëndrueshëm me energji në mënyrë që të arrihet qëndrueshmëria dhe të rikthehet besimi në sektorin energjetik. Qeveria është angazhuar për të siguruar bashkëpunimin e të gjithë ministrive dhe institucioneve publike për implementimin e planit.

Sipas këtij plani, brënda një periudhë 5 vjeçare kapitali negativ i shoqërisë do të ulej në 43 miliardë Lekë. Në fakt rezultatet deri në fund te vitit 2017 tregojnë se kapitali negativ i shoqërisë është ulur në 33.7 miliard Lekë, kjo vetëm gjatë periudhës tre vjeçare 2015-2017, duke qënë optimist se ky tregues edhe në vitet e ardhshme do të vazhdojë të përmisohet ndjeshëm. Fokusi kryesor i shoqërisë do të vazhdojë të jetë përmirësimi i treguesve të përformancës së OSHEE-s, reduktimi i humbjeve teknike dhe joteknike dhe rritja e normës së arkëtimit.

Ngritja dhe vazhdimin e punës së njësisë së Task Force të themeluar nga Qeveria Shqiptare në Dhjetor 2013, është një garanci më tepër për mbështetjen e Qeverisë. Roli i grupit të punës të kësaj njësie është mbështetja e Shoqërisë në përmirësimin e normës së arkëtimit dhe të humbjeve, duke kryer inspektime në terren dhe ndërprerë furnizimin me energji elektrike në rastet e vjedhjeve dhe faturave të papaguara.

Në zbatim të ligjit "Për Sektorin e Energjisë" prej datës 1 Korrik 2016 OSHE kryen aktivitetin e Furnizuesit Universal si dhe rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të licensuar nga ERE.

Qeveria, nëpërmjet Ministrisë së Financave, ka mundësuar kreditimin e shoqërisë me hua me interesa të ulëta. Marrëveshja e nënhuasë e nënshkruar ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe OSHEE në Dhjetor 2014 për 69.7 milion Euro e financuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), është lëvruar deri në fund të vitit 2017 vlera 21.5 milion Euro dhe gjatë 4-mujorit parë të vitit 2018 vlera 4,3 mln Euro.

Gjatë vitit 2018 e në vazhdim, investimet si pjese e projektit të kësaj marrveshje pritet të jenë shumë më të larta, duke përmirësuar ndjeshëm rrjetin teknik të shpërndajes së energjisë.

d. Menaxhimi i likuiditetit

Në përputhje zbatim të kushteve të vendosura nga marrëveshja e kredisë me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH) dhe kushteve të përcaktuara në Planin për Rimëkëmbjen Financiare në Sektorin e Energjisë Elektrike, gjatë vitit 2017 Shoqëria duhet të shlyente 95% të energjisë së blerë nga KESH-i dhe të shërbimeve të transmetimit të marra nga OST-ja, ndërkohë shoqëria pagoi 102% të faturave vjetore të blerjeve nga KESH-i dhe 98% te blerjeve nga OST-ja. Sipa marrëveshjes shuma gjatë vitit në vazhdim 2018 do të jetë në 100% të faturave vjetore dhe për këtë shoqëria ka marrë të gjitha masat për realizimin e saj.

Detyrimet sipas marrveshjes me CEZ a.s. janë përmbushur me pagesën e rradhës prej rreth 21 milion Euro për vitin 2017 dhe në llogarinë escroë është duke u grumbulluar shuma e nëvojshme për pagesën e fundit të detyrimit, ne muajin Gusht të vitit 2018.

Pagesat ndaj furnitorëve të tjerë për shërbime dhe mallra të aktivitetit të Shoqërisë gjatë vitit 2017 janë shlyer në kohë sipas datëpagesës së përcaktuar në kontratë.

Rritja e vlerës së furnitorëve për energji elektrike nga importi ka ardhur nga blerjet e fundvitit pagesa e të cilave është brenda afateve ligjore te vendosura në kontratat përkatëse.

Gjatë vitit 2017 u miratua ligji për faljen fiskale, nga i cili OSHEE përfitoj një shumë rreth 5.4 miliard Lekë, në faljen e detyrimeve tatimore të prapambetura dhe penalitetet e tyre, duke lehtësuar kështu shoqërinë nga sforcimi për pagesat e prapambetura dhe penalitetet e tyre.

Drejtimi e njeh pasigurinë mbi aftësinë e Shoqërisë për të përmbushur kërkesat e saj të financimit dhe mbi financimin apo shlyerjen e pagesave në kohën e duhur. Megjithatë, siç përshkruhet më sipër, drejtimi ka një pritshmëri të arsyeshme se Shoqëria ka burime dhe mbështetje të mjaftueshme nga qeveria për të vazhduar aktivitetet operative për të ardhmen e parashikueshme.

Marrëveshja me KESH për skedulimin e pagesave të detyrimit me qëllimin e shlyerjes së plotë të pakushtëzuar dhe përfundimtare të të gjithë detyrimit që OSHEE ShA ka ndaj KESH Sha, të nënshkruar më datën 6 Prill 2018 do të ndihmojë shumë shoqërinë në menaxhimin e likujditeteve pa sforcimin e pagesavë të prapambetura.

e. Masa të tjera

Duhet theksuar se rritja e jashtëzakonshme e investimeve pa cënuar nivelin e planifikuar të likuiditetit është arrritur duke u mbështetur tërësisht rezultatet pozitive të aktivitetit të shoqërisë.

Zbatimi në praktikë i ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë" datë 30.04.2015 është duke u shoqëruar me plotesim të kuadrit ligjor sipas parashikimit ku më të rëndësishme janë Vendimi i Këshillit të Ministrave për Modelin e Tregut Nr.244, date 30.3.2016 "Per miratimin e kushteve per vendosjen e detyrimit te sherbimit publik, ..." si dhe vendimeve të ERE për ndryshime në rregulloret në mbështetje dhe zbatim të ligjit dhe modelit të tregut.

Proçesi i ndarjes së aktitviteteve me krijimin e shoqërive të reja nga OSHEE, përkundrejt vazhdimit të punës për përmirësimin e treguesve ekonomiko - financiare dhe menaxheriale, është një proces që po zhvillohet nën këshillimin e konsulences dhe eksperiencës më të mire të huaj dhe nën vëzhgimin dhe ndjekjen hap pas hapi në menyrë të drejtëpërdrejtë të Qeverisë Shqiptare.

Në përfundim:

Vijimësia e aktivitetit të Shoqërisë OSHEE sha, për rëndësinë që ajo ka në shpërndarjen e energjisë elektrike por edhe bazuar në përmirësimin e dukshëm të treguesve kryesorë, në masat e marra nga Administrimi e në veçanti nga Qeveria, garantojnë vazhdimësinë e akivitetit të shoqërisë.

5. *Aktivet Afatgjata Materiale*

Ndryshimet në zërat e Aktiveve Afatgjata Materiale për vitin 2017 dhe krahasimi i gjendjeve me vitit 2016, paraqiten si më poshtë:

	Toka	Rikonstr Ndert&Toka	Makineri e Paisje	Asete te Tjera	Asete ne proces	Total 2017	Total 2016
Çelje me 1.1.2017	1,035,447	2,972,000	29,344,288	1,385,879	4,846,388	39,584,002	41,585,042
Korigj vleres bruto	-	-	-	-	-	-	(12,066,220)
Shtesat	-	778,809	7,089,042	629,681	11,582,600	20,080,132	10,685,187
Pakesime	(2)	(292)	(7,396)	(305)	(8,593,624)	(8,601,619)	(1,299,945)
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-	-
Gjendje 31.12.17	**1,035,445**	**3,750,517**	**36,425,934**	**2,015,255**	**7,835,364**	**51,062,515**	**39,584,002**
Amortizimi Akum me 1 Janar 2017	-	(126,424)	(9,308,339)	(777,057)	-	- 10,211,820	(20,503,820)
amortizimit te akumuluar per rivleresimet	-	-	-	-	-	-	12,066,220
Amorti vjetor 2017	-	(135,719)	(1,945,387)	(258,264)	-	2,339,370	(1,774,220)
Vera neto e Aktive te ç'regjistruara	-	24	-	-	-	24	-
Pakesimi	-	7	866	32	-	905	-
Riklasifikimi	-	-	-	-	-	-	-
Amortizimi Akum me 31.12.2017	**-**	**(262,112)**	**- (11,252,860)**	**(1,035,289)**	**-**	**- 12,550,261**	**(10,211,820)**
31.12.2017	**1,035,445**	**3,488,405**	**25,173,074**	**979,966**	**7,835,364**	**38,512,254**	**29,372,182**

Investimet në proces janë përfshirë në tabelën e mësipërme por të dhena më ë detajuara janë si më poshtë :

Investime në Proces	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Gjendja në fillim të periudhës	4,846,388	2,442,141
- Shtesa gjatë vitit	11,582,600	3,689,439
- Paksime gjatë vitit	(8,593,624)	(1,284,192)
Gjendje në fund të periudhës	**7,835,364**	**4,846,388**

Ndërtimet në proces kanë rritje me vitin e mëparshëm per 3 miliard mln Lek. Kjo rritje e vlerës së Aktiveve, ka ardhur si rezultat i rritjes së investimeve ne vlerën 12 miliard lekë, në rrjetin shpërndarës të energjisë, në tension të mesëm e tension të ulët, të mbetura në proces investimi në fund të periudhës, megjithë kapitalizimin e vlerës 9 miliard lekë .

Rivlerësimi

Në PF të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetor 2017, janë përfshirë efektet financiare nga zbritja e rezervës së rivleresimit e cila në 31.12.2017 rezulton me vlerë 1,250,030 mijë lekë

Tabela më poshtë jep të dhënat e gjendjes ne lekë të llogarisë së rezervës së rivlerësimit në fillim të periudhës raportuese dhe në fund të saj :

Përshkrimi	Më 31 Dhjetor 2016	Zbritje të vitit 2016	Zbritje të vitit 2017	Më 31 Dhjetor 2017
Toka	68,669,597	91	68,668,743	763
Makineri e Paisje	926,986,586	69,643,166	68,588,952	788,754,467
Mjete transporti	13,844,794	4,966,691	3,536,448	5,341,655
Paisje zyre	647,141	51,203	51,202	544,736
Paisje informatike	4,487,434	248,786	248,782	3,989,866
Totali	**1,513,463,131**	**98,802,887**	**164,630,027**	**1,250,030,217**

Zbritjet gjatë periudhës përfaqësojnë rregullimin e amortizimit për asetet e rivlerësuara gjatë periudhave 2016 dhe 2017, evidentuar në pasqyrat fiancniare periudhës tatimore 2017.

Amortizimi

Të dhëna për amortizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Aktiveve Afatgjata Jomateriale, të llogaritur në 31 Dhjetor 2017 dhe 2016, janë si më poshtë :

Amortizimi i llogaritur	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Amortizimi AAJM - menaxherial	190,443	61,084
Amortizimi AAM - menaxherial	2,338,466	1,774,221
Shuma Am Menaxherial	**2,529,814**	
Amortizimi AAJM - Fiskal	106,389	55,005

Amortizimi AAM - Fiskal	2,230,954	1,881,440
Shuma Am Fiskal	**2,427,343**	**1,936,445**
Diferenca Menaxherial - Fiskal	101,565	(101,140)

Amortizimi i AAM dhe AAJM llogaritet nga sistemi SAP në dy mënyra, menaxherial dhe fiskal. Në tabelën e mësipërme është rregjistruar amortizimi menaxherial, i cili ka pësuar rënie nga viti i mëparshëm për arsye të plotësimit të viteve të jetës të shumë aseteve të cilët janë amortizuar 100%.

Lista e pasurive të paluajtshme të shoqërisë është miratuar në pronësi me vendimi të Këshillit të Ministrave. Kalimi i titujve të pronësisë për tokën e ndërtesat nga KESH ShA, rregjistruar shumica e tyre në momentin fillestar, në pronësi të shoqërisë, akoma nuk ka përfunduar. Shoqëria kohët e fundit i ka intensifikuar përpjekjet e saj për të marrë këto tituj pronësie, por ka mundur të zotërojë vetëm një pjesë të këtyre titujve.
Inventarizimi i Aseteve gjate vitit 2017,per shkak te mospermbushjes se kritereve te vendosura nga subjektet pjesemarrese, kjo procedure tenderimi deshtoi duke mos patur asnje fitues.

Ne 6-mujorin e 2-te 2017 pritej qe ky Sherbim te ri-tenderohej, por per shkak te situates se jashtezakonshme financiare te OSHEE per shkak te prodhimit te ulet te Energjise nga ana e KESH, ku gjate kesaj periudhe u pezulluan gjithe investimet dhe shpenzimet jo imediate te shoqerise, ku sherbim u planifikua te shtyhej ne nje moment te dyte.

Aktualisht situata financiare e OSHEE eshte duke u permiresuar gradualisht, keshtu qe u be ri-hapja e procedurave te tenderimit per Inventarizimin e Aseteve , me Urdher prokurimi nr 16545/3 date 21.09.2018 me objekt " Inventarizimi dhe vleresimi i Aktiveve Materiale Afatgjata te Oshee sha si dhe ngritja e sistemit te administrimit dhe pergatitja e procedurave te brendshme te menaxhimit te tyre " dhe aktualisht ka përfunduar procedura e vlerësimit shpallur , nga ku pritet dhe lidhja e kontratës

6. Aktivet Afatgjata Jomateriale

Vlera neto e Aktiveve Afatgjata Jomateriale në 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

	Marka Tregtare dhe Licenca	AAJM në Proces	Totali 2017	Totali 2016
Vlera Bruto në 01 Janar, 2017	**460,204**	**203,824**	**664,028**	**508,807**
Korigjin i vlerës bruto	-	-	-	(45,277)
Rivlerësime	-	-	-	(9,197)
Shtesa	429,774	437,020	866,794	209,694
Pakësime	(147)	(383,363)	(383,363)	0
Vlera Bruto,31 Dhjetor, 2017	**889,831**	**257,481**	**1,147,312**	**664,027**
Amortizimi i Akumuluar në 01 Janar 2017	**(151,687)**	-	**(151,687)**	**(135,880)**
Korigjimi vleres Amortiz te akumuluar para rivleresimit				45,277
Shtesa	(190,444)		(190,444)	(61,084)
Pakësime	1		1	0
Amortizimi i Akumuluar në 31 Dhjetor 2017	**(342,130)**	-	**(342,130)**	**(151,687)**

Vlera Neto e Aktiveve Jomateriale, 31 Dhjetor 2017	**547,701**	**257,481**	**805,182**	**512,340**

Vlerat e aktiveve jomateriale i referohen licencave të IT, SAP, Sistemin e Faturimit si edhe licencave të tjera për programe kompjuterike.

7. Aktive Financiare

Vlera neto e aktiveve financiare në 31 Dhjetor 2017 dhe në 2016 është si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Të Arkëtueshme nga punonjësit	23,103	23,249
Totali	**1,461**	**1,606**

Aktivet financiare të kompanisë përbëhen nga dhënia e huave punonjësve të saj në vitet e mëparshme. Me kalimin e viteve një pjesë e kredimarrësve janë larguar nga Shoqëria duke mos pasur një adresë të saktë të tyre. Në kontabilitet janë njohur me detyrimin në 31.12.2017 minus zbritjet për kreditë e dhëna (borxhi i keq) e cila përfaqëson vlerën e palikujduar dhe të provizionuar për punonjësit e larguar nga shoqëria.

8. Tatimi fitimi i shtyrë

Tatim fitimi i shtyrë neto në fund të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016, përbëhet si më poshtë :

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Provigjonet për kreditë e këqija	8,355,205	8,329,610
Provigjone të tjera	735,285	1,131,156
Totali i Tatim fitimit të shtyrë	9,769,807	10,126,106
Tatimi i shtyrë i tatueshëm i parregjistruar	(9,769,807)	(10,126,106)
Tatimi i shtyrë i njohur	-	-

Zbritjet përfaqësojnë efektin e taksave për zbritjet në llogaritë e arkëtueshme të dyshimta, zbritjet për huatë e dyshimta të punonjësve, rënien në vlerë të inventarit dhe zbritje të tjera të lidhura me debitorët.

Provizonet e tjera përfaqësojnë efektin e taksave për provigjone të krijuara për çeshtje ligjore, kontrollet tatimore, etj.

Shoqëria nuk e ka njohur dhe as nuk e ka rregjistruar tatimin e shtyrë, për shkak të pasigurisë që ekziston në lidhje me rimarrjen e tatimit të shtyrë.

9. Inventarët

Të gjitha materialet të cilat përbëjnë inventarin e Shoqërisë përdoren për operacionet e mirëmbajtjes ditore ose përndërtimin e aktiveve të reja. Për materialet e përdorura në mirëmbajtje, konsumi vjetor është regjistruar në llogaritë kontabile përkatëse të shpenzimeve.

Në vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017, vlera e shpenzimeve të bazës materiale, karburanteve, kancelari etj., është 929,785 mijë lekë nga 976,205 mijë lekë në vitin 2016.

Zhvlerësimi i inventarit gjëndje në 31 Dhjetor 2017 në vlerë totale 360,059 mijë lekë nga vlera 218,622 mijë lekë në vitin 2016, lidhet me vlerën e artikujve të përcaktuar si njësi të cilat vlerësohen se janë inventar për jashtë përdorimit e me qarkullim të ngadalshëm dhe se mundesia e përdorimit të tyre është zero.

Në fund të vitit 2017, është kryer inventarizimi i artikujve të stokut të magazinave dhe njëkohësisht janë evidentuar artikujt me qarkullim të ngadalshëm dhe ato që duhet të dalin jashtë përdorimit, duke mbajtur procesverbale për çdo magazinë nga komidsionet e inventarizimit.
Kriteret për t'i klasifikuar si materiale me qarkullim të ngadalshëm kanë qenë: (i) vjetërsia e blerjes së tyre ; (ii) njësi të papërdorshme në rrjetin aktual të shpërndarjes. Ndërsa për inventarin përcatuar për jashtë përdorimit, vlerësimi është bërë nisur nga : (i) ndryshimi i teknologjisë ; (ii) dëmtimi në magazinë (nga qëndrimi i gjatë) ; (iii) materiale të hequra (demontuara) nga rrjeti shpërndarës.

Kështu rënia në vlerë e inventarit gjendje më 31.12.2017, është evidentuar për çdo artikull dhe sipas magazinave duke mbajtur procesverabale të veçanta për këtë proces.

Balanca e inventarit në 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

	Më 31.12.2017	Më 31.12.2016
Artikuj Konsumi	6,403,958	4,687,430
Rënie në vlerë e inventarëve	(360,059)	(218,622)
Totali	**6,043,898**	**4,468,808**

Në vitin 2017 kemi rritje të gjendjes së stokut në magazinë si rezultat i blerjeve të materialeve për kryerjen e investimeve. Gjithashtu ka rritje të gjendjes së materialeve të zhvlerësuara që kryesisht ka ardhur nga demontimi i materialeve gjatë procesit të investimeve.

10. Llogaritë e Arkëtueshme

Llogaritë e Arkëtueshme të Shoqërisë, përbëhen nga faturat e papaguara të energjisë elektrike dhe paraqiten si më poshtë:

	Më 31.12.2017	Më 31.12.2016
Llogari të Arkëtueshme	72,966,001	72,520,353
Minus: zbritje për llogaritë e Arkëtueshme	(52,033,937)	(52,004,740)

Vlera e llogarive të Arkëtueshmeve është rritur për vlerën 446 milion leke në krahasim me vitin e kaluar. Ndikimin më të madh në rritjen e debisë këtyre llogarive e kanë rritja e debisë e klientëve Jobuxhetorë për 1,765 milion lekë dhe e klientëve privatë për 957 milion lekë , Buxhetore 230 mil dhe ulje ne klientet familjare me 2,505, milion leke.
Gjatë vitit 2017, pati edhe ulje të debisë së klientëve familjarë si rezultat Rakordimit me Postën shqiptare dhe i marrjes në evidencë kontabël të arkëtimeve nga Posta por të mbetura në "diferenca në shqyrtim" nga OSHEE. Efekti nga këto sistemime është 1,177 milion lekë.
Gjithashtu ka patur edhe arkëtime të "Klintëve Me marreveshje" duke e ulur debine për 392 milion lekë.
Llogaritë e arkëtueshme tregtare të gjeneruara nga sistemi i faturimit janë më të ulta se regjistrimet kontabël me 1,169,392 mijë Lekë më 31 dhjetor 2017.
Ne fund te vitit 2017, në llogarinë e Fondeve pa adresë, rezulton vlera 143,399 mijë lekë, e cila përfaqëson fondet e arkëtuara pa adresë të saktë të klientit, trashëguar ndër vite. Megjithë angazhimin për indentifikimin e tyre, gjatë vitit 2017 është identifikuar vlera 1,798 mijë Lek. Gjithashtu janë shtuar fonde të paindentifikuara vlera 3,885 mijë Lek. Në fund të vitit 2017 vlera e këtij fondi është më e lartë se viti i mëparshëm për vlerën 2,077 mijë Lek.

Një prezantim i llogarive të arkëtueshme sipas kategorive të klientëve dhe periudhave të krijimit të gjendjeve, për vlerat e papaguara të llogarive të Arkëtueshme dhe provizionimi i tyre në referncë të vjetërsisë të evidentuar në Billing Sistem, më 31 Dhjetor 2017 paraqitet si me poshtë:

Vjetersia		Buxhetore	Familjare	Jo-Buxhetore	Private	Klient me marreveshje	Gjendja më 31.12.2017
P1	0-1 muaj	276,321,973	2,664,601,699	68,790,921	2,019,568,880	447,890,833	**5,477,174,306**
P2	2 muaj	11,213,928	250,919,316	2,813,983	278,132,530	121,504,505	**664,584,262**
P3	3 muaj	7,771,124	79,258,414	5,627,329	79,912,844	39,097,708	**211,667,419**
P4	4-6 muaj	31,446,707	144,025,375	46,830,202	147,716,795	52,477,890	**422,496,969**
P5	7-12 muaj	139,422,407	130,867,717	74,511,991	157,842,897	84,708,911	**587,353,923**
P6	13	32,498,875	20,583,884	633,619	14,759,673	11,319,377	79,795,429
	14	1,210,201	12,960,539	470,180	25,222,932	10,726,300	50,590,152
	15	5,659,344	14,790,376	485,166,642	29,643,797	8,714,119	543,974,278
	16	7,821,200	15,708,952	2,623,209	11,252,290	42,524,920	79,930,570
	17	10,437,635	11,967,326	2,072,835	9,180,098	6,902,436	40,560,331
	18	14,317,741	12,943,286	6,107,628	9,751,966	9,805,170	52,925,792
	19	10,801,633	12,856,886	7,556,931	8,002,120	7,503,285	46,720,855
	20	15,710,661	14,923,165	12,010,720	19,486,220	22,699,382	84,830,148
	21	9,636,669	15,536,433	8,338,744	13,821,916	10,942,090	58,275,852
	22	33,367,221	18,481,815	125,049,769	11,564,083	26,617,329	215,080,218
	23	9,605,372	10,813,599	19,737,775	9,791,222	26,606,518	76,554,486
	24	16,002,256	8,119,895	10,483,361	6,479,210	14,378,329	55,463,051
	>24	390,769,076	5,706,092,234	8,007,426,839	23,193,130,395	27,064,003,759	64,361,422,303
	P6 - Total	557,837,885	5,875,778,391	8,687,678,252	23,362,085,922	27,262,743,015	**65,746,123,464**
Balanca		**1,024,014,024**	**9,145,450,911**	**8,886,252,678**	**26,045,259,868**	**28,008,422,861**	**73,109,400,343**

Provizionimi

Më poshtë është tabela e nivelit të provizionimit sipas vjetërsisë :

Vjetërsia		Zhvlerësimi Kolektiv	Zhvlerësim Klient me marreveshje	Shuma e Zhvlerësimit	Balanca Neto më 31.12.2017
P1	0-1 m	-123,355,607	-209,793,686	-333,149,293	5,144,025,013
P2	2 m	-43,044,589	-55,814,230	-98,858,819	565,725,444
P3	3 m	-36,340,412	-17,893,791	-54,234,203	157,433,216
P4	4-6 m	-156,162,621	-24,642,374	-180,804,995	241,691,974
P5	7-12 m	-339,185,462	-39,045,317	-378,230,779	209,123,144
P6	13	-60,528,921	-5,226,280	-65,755,201	14,040,229
	14	-33,455,160	-4,979,375	-38,434,535	12,155,616
	15	-474,241,423	-4,136,211	-478,377,634	65,596,643
	16	-32,335,375	-18,671,201	-51,006,576	28,923,994
	17	-29,894,036	-3,595,145	-33,489,181	7,071,150
	18	-38,850,850	-4,709,177	-43,560,027	9,365,764
	19	-35,262,553	-3,630,195	-38,892,748	7,828,107
	20	-56,590,392	-10,448,759	-67,039,151	17,790,997
	21	-43,063,851	-5,266,252	-48,330,103	9,945,749
	22	-171,697,940	-14,398,574	-186,096,514	28,983,704
	23	-46,092,600	-15,936,686	-62,029,286	14,525,200
	24	-39,154,347	-6,874,309	-46,028,656	9,434,395
	>24	-35,261,777,531	-14,567,841,382	-49,829,618,913	14,531,803,390
	P6 total	-36,322,944,979	-14,665,713,547	-50,988,658,526	14,757,464,938
Zhvlerësimi		-37,021,033,670	-15,012,902,945	**-52,033,936,615**	x
Balanca		**45,100,977,481**	**28,008,422,861**	**73,109,400,342**	x
Balanca- Neto		**8,079,943,811**	**12,995,519,916**	x	**21,075,463,727**

Në fund të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetor 2017, ka rezultuar rritje e vlerës akumulative totale të provizionit për 29,197 mijë Lekë. Kjo ka ardhur nga ndikimi i paksimit të provizionit për klientët familjarë vlera 2,223,965 mijë Lekë dhe rritje te klientëve të tjerë për vlera 2,253,162 mijë Lekë.

Provizionimi i klientëve është bërë sipas metodologjisë së përgatitur nga Ekspertë të pavarur dhe miratuar me Vendim të Këshillit Mbikqyrës.
Baza llogaritëse është vjetërësia e krijimit të gjendjes së klientëve.

11. Të Tjera të Arkëtueshme

Llogari të tjera të Arkëtueshme paraqiten si me poshtë:

	2017	2016
Të Arkëtueshme ndaj personelit , neto	2,906	2,791
Debitorë të tjerë per jo energjinë, neto	25,590	53,832
Të Arkëtueshme nga shitja e materialeve	12,766	12,766
Shpenzime të parapaguara/Të ardhura të llogaritura	5,543,701	70,065
Të tjera	645,009	209,266
Totali	**6,229,972**	[illegible]

Llogaritë e tjera të arkëtueshme neto, përmbajnë gjithashtu të arkëtueshmë sipas detajeve të mëposhtmë, sipas vlerës së aktivit të krijuar dhe provizionimit të tyre :

a) Të Arkëtueshme ndaj personelit

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Te arketueshme nga personeli	5,204	5,088
Provizione te detyrimeve te personelit	(2,298)	(2,298)
Totali	**2,906**	**2,791**

Të Arkëtueshme nga punonjësit rrjedhin nga detyrimi i punonjësve për shërbimin e telefonit për llogari të Vodafon por edhe detyirme të tjera të punjonjësve ndaj shoqërisë. Zbritjet lidhen me faktin që një pjesë e këtyre punonjësve janë larguar nga Shoqëria.

b) *Debitorë të tjerë për jo energjinë*

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Klientë - OST per disbalanca	0	42,001
Kliente për lidhje të reja	8,797	[illegible]
Kliente aktivitete te ndryshme	2,218	2,121
Të tjera	14,575	162
Totali	**25,590**	**53,832**

Rritja e balancës së debitorëve të tjerë në krahasim me vitin e mëarshëm, ka ardhur kryesisht nga vlera e penaliteteve të faturuara shoqërive kontraktore për energjinë dhe investime vlera 14,549 mijë lekë pa arkëtuar deri në fund të periudhës, nga e cila vlera 14,412 mijë lekë faturuar ne Nëntor-Dhjetor 2017.

c) *Të Arkëtueshme nga shitja e materialeve*

Vlera 12,766 mijë Lek, të arkëstueshme nga shitja e materialeve, trashëgohet nga para vitit 2013 dhe ka të bëjë me shitje materialesh skrap.

d) Shpenzime të parapaguara/Të ardhura të llogaritura

Kjo balancë, përbëhet nga :

- shpenzime të parapaguara e për tu shpërndarë në vitin e ardhshëm, vlera 75,300 mijë lekë, ku pjesën kryesore e përbën marrëveshja huapërdoje me KESH për disa ndërtesa në Durrës ku shoqëria ka bërë riparimin dhe kostot do ti shpërndajë në periudhën e përdorimi pesëvjeçar ;
- te ardhura te llogaritura vlera 5,468,401 lekë ku pjesën kryesore vlera 5,465,003 mijë lekë e përbën penaliteti i llogaritur për tu paguar nga KESH nga mosrealizimi i kontratës së furnizmit me energji elektrike.Ne date 20.12.2018 Ministri i Infrastruktures dhe Energjise ka vendosur qe Kesh sha te pranoje faturen e penaliteteve.

e) Debitorëtë tjerë, neto

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Debitorë të tjerë që nuk lidhen me energjinë	889,906	454,163
Zbritje për Debitorë të tjerë	(244,897)	(244,897)
Totali	**209,266**	**209,266**

Në vlerën e debitorëve përfshihen :

- Ekzekutime nga Njësitë Vendore per taksa e tarifa vlera 190,940 mijë lekë, Ekzekutime nga përmbarimi vlera 76,392 lekë, Garanci për ankime të taksave e tatimeve vlera 41,741 lekë, të cilat ndiqen me procese gjyqësore ;
- Vlera 149,708 mijë lekë për debitor pa adresë vendosur në proces shqyrtimi ;
- Vlera 292,633 mijë lekë e faturës nga Vibtis por pa ardhur furnizmi ;
- Vlera 56,395 mijë lekë nga rakordimi me Postën Shiqptare, për kreditime të klientëve pa indentifikuar fondet monetare ;
- Detyrime të tjera nga punonjësit apo të tretë të cilat janë në proces arkëtimi.

f) *Të Arkëtueshme nga KESH sh.a. në bazë neto*

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Të Arkëtueshme nga KESH Sha	1,917,247	1,917,247
Zbritje për të Arkëtueshme nga KESH Sha	(1,917,247)	(1,917,247)
Totali	-	-

Kjo vlerë rrjedh nga marrëdhëniet ndërmjet Shoqërisë dhe KESH sh.a në pjesën e dytë të vitit 2008, kur të dy shoqëritë ishin në pronësi të Ministrise së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë.
Megjithëse është pranuar si balancë nga ndarja, akoma nga KESH ShA nuk është njohur si detyrim. Edhe kjo e drejtë nga KESH është përfshirë në problematikat për zgjidhje nga komisioni i posaçëm ngritur me Udhër të Kryeministrit.

(g) Të Arkëtueshme-të verbër me bazë neto

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Të Arkëtueshme- të verbër	3,038,536	3,038,536
Zbritje për të Arkëtueshme nga KESH Sha	(3,038,536)	(3,038,536)
Totali	-	-

Kjo vlerë përbëhet nga pjesa 80% e faturave te energjisë elektrike të të verbërve, detyrim të cilin shoqërisë duhet tia kompensojë buxheti i shtetit, në bazë e për zbatim të Ligjit nr. 8098 datë, 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit". Ky ligj është zbatuar deri në Prill 2012.

Vlera e këtij detyrimi 3,038,536 mijë lekë, megjithëse i provizionuar, pretendohet të përfitohet nga shteti nëpërmjet paksimit të detyrimeve tatimore dhe është përfshirë në problematikat për zgjidhje nga komisioni i posaçëm ngritur me Udhër të Kryeministrit.

12. Mjete Monetare dhe ekuivalente me to

Aktivet monetare në PF i korrespondojnë vlerave të mjeteve monetare në arkë e bankë, të sipas informacioneve të mëposhtëm, në 000 Lek :

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Llogari arka e bankare rrejdhëse	**3,957,032**	**1,249,911**
Para në Tranzit	**178,744**	**40,084**
Totali	**4,135,776**	**6,739,895**
Nga llog bankare Rrjedhëse-Garanci/Escrow	2,424,915	

(a) Mjete monetare ne Bankë dhe në Arkë

Gjendja e mjeteve monetare në bankë dhe në arkë (llogari rrjedhëse dhe të ngurtësuara) në 31.12.2017 sipas llogarive kontabël të lidhura me llogaritë e veçanta bankare, është si më poshtë vijon, në lekë :

Llogaria	Përshkrimi i llogarisë kontabël-bankare	më 31.12.2017
512110	Raiffeisen Bank HQ ALL	129,822,599.73
512112	Raiffeisen Bank HQ USD	444,122.25
512113	Raiffeisen Bank Arketimet ALL	(2,501.59)
512114	Raiff Bank - Arketime Tarife Permb ALL	(251.79)
512120	Banka Kombetare Tregtare HQ ALL	112,962,943.67
512121	Banka Kombetare Tregtare HQ EUR	66,852.58
512122	Banka Kombetare Tregtare Arketimet ALL	40,782.96
512131	Intesa SanPaolo Bank HQ EUR	138,228.12
512132	Intesa SanPaolo Bank Arketimet ALL	-
512135	Credins Bank Escroë OSHEE & M.B. ALL	-
512137	Credins Bank - Depozite ne Euro	22,586.88
512138	Credins Bank, Proj Rimëk Energj Komp 2 Euro	383,565,088.16
512139	Credins Bank, Proj Rimek Energj, Komp 2 ALL	130,992.99
512140	Credins Bank HQ ALL	795,352.97
512141	Credins Bank HQ EUR	2,025,626.20
512142	Credins Bank Arketimet ALL	127,907,714.10

512143	Credins Bank Escroë KESH & OST ALL	57,167,353.32
512144	Credins Bank Escroë CEZ a.s ALL	7,246,183.33
512146	Credins Bank Escroë Import EUR	179,612,748.46
512147	Credins Bank GBP	5,488.17
512148	Credins Bank Escroë Import ALL	62,527,859.91
512152	Union Bank Arketimet ALL	31,454,699.70
512153	Credins Bank Escroë KESH-Kredi ALL	145,307.17
512154	Credins Bank Escroë KESH-Kredi EUR	54,290.13
512156	Credins Bank Escroë Ashta ALL	2,132,978.10
512157	Credins Bank Escroë Hua Min Fin - ALL	65,929.39
512159	Credins Bank card Crediti - Euro	(664.75)
512160	Procredit Bank HQ ALL	100,000,000.00
512162	Procredit Bank Arketimet ALL	104,403,417.16
512182	Tirana Bank Arketimet ALL	5,856,966.40
512190	Societe General Bank HQ ALL	(10,750.40)
512193	Societe General Bank Arketimet ALL	17,008,378.43
512221	Veneto Bank Arketime ALL	14.58
512230	Banka Amerikane e Investimeve HQ ALL	14,772,566.93
512231	Banka Amerikane e Investimeve - Arketime ALL	-
512232	Banka Amerikane e Investimeve - Depozite ALL	4,567,053.58
512233	Banka Amerikane e Investimeve - Euro	29,083,370.89
512234	ABI Bank Escroë Ashta ALL	1,167,566.43
512300	Llogari Bankare te Bllokuara per Garanci ALL	10,020,506.02
531100	Arka - LEKE	152,950.00
531200	Arka - EURO	175,282.61
	Shuma	**3,957,031,724.47**

(b) Mjete monetare ne tranzit

Në fund të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetor 2017, disa nga vlerat monetare, nuk ishin në llogarinë bankare por ishin në tranzit në sistemin bankar, konkretisht ne vlerat e mëposhtëme, në lekë, :

581000	Transferime te brendshme ALL	744,578.00
582000	Para ne tranzit ALL	177,999,999.87
	Shuma	**178,174,577.87**

(c) Mjete monetare ne Bankë të ngurtësuara

Nga gjendja e mjeteve monetare në bankë, tek shkronja (a) , pjesa e ngurtësuar në Garanci dhe Escrow më 31.12.2017 sipas llogarive bankare është si më poshtë vijon, në lekë, :

512136	Credins Bank - Depozite ALL	600,499,827.88
512137	Credins Bank - Depozite ne Euro	22,586.88
512139	Credins Bank, Proj Rimëk Energj Komp 2 Euro	130,992.99
512143	Credins Bank Escrow KESH & OST ALL	57,167,353.32
512144	Credins Bank Escrow CEZ a.s ALL	7,246,183.33
512146	Credins Bank Escrow Import EUR	179,612,748.46
512148	Credins Bank Escrow Import ALL	62,527,859.91
512153	Credins Bank Escrow KESH-Kredi ALL	145,307.17
512154	Credins Bank Escrow KESH-Kredi EUR	54,290.13
512155	Credins Bank Escrow Ashta Euro	9,575,110.85
512156	Credins Bank Escrow Ashta ALL	2,132,978.10
512159	Credins Bank card Crediti - Euro	(664.75)
512234	ABI Bank Escroë Ashta ALL	1,167,566.43
512235	ABI Bank Escroë Ashta Euro	101,615.01
	Shuma	**2,424,914,766.83**

13. Kapitali Aksioner

Shoqëria është themeluar më 19 Qershor 2007, duke u bazuar në Vendimin Nr.862 të Këshillit të Ministrave, të datës 20 Dhjetor 2006. Kjo Kompani u themelua si rezultat i ndarjes nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a ("KESH" ose "Shoqëria Mëmë") dhe filloi aktivitetin e saj operativ që prej 1 Janarit 2007.
Më 29 Maj 2009, CEZ a.s, Pragë, u bë pronar i 76% të aksioneve të Kompanisë, 24% të aksioneve mbetën në pronësi të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga METE.
Në Qershor 2014, Qeveria e Shqipërisë, lidhi Marrëveshje me CEZ a.s, për zgjidhjen me mirkuptim të çeshtjes së detyrimeve dhe të pronësisë (aksioneve). Kjo marrëveshje e miratuar me ligjin nr.114/2014 dt.31.07.2014, vendosi transferimin i aksioneve nga CEZ AS shtetit shqiptar, anullimin e të ardhurave të arkëtueshme (detyrimeve) dhe shumën e zgjidhjes me pajtim (detyrimi i ri ndaj CEZ AS).
Më datën 23.10.2014, aksionet e Shoqërisë u rregjistruan 100% në pronësi të Ministrisë Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë e Sipërmarrjes, si aksioner i vetëm.
Më datë 6 Qershor 2016, aksionet e shoqërisë janë rregjitruar në pronësi të Ministrisë Energjisë dhe Industrisë si përfaqësuese e pronarit shtet, transferuar kështu nga ish aksionari Ministria e Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjitikës.
Në vitin 2016, Kapitali i shoqërisë është zvogëluar. Me urdhër të Pronarit (MEI) nr.403 dt.06.12.2016, kapitali i shoqërisë është zvogëluar me vlerë 15,752,000 Lek, i barabartë me 15,752 aksione me vlerë nominale 1,000 Lek secila. Ky paksim ka ardhu nga paksimi i aktiveve afatëgjatë në zërin "Tokë".

Në fund të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetor 2016, kapitali i shoqërisë është 30,083,349,000 Lek, i barabartë me 30,083,349 aksione me vlerë nominale 1,000 Lek secila .
Rezervat e tjera u pakësuan në vitin 2016, me 361 Lek, me të njejtin vendim të paksimit të kapitalit.
Në fund të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetor 2016, Rezervat e Tjera janë 2,916,010,454 Lek.

Në vitin 2017 Kapitali i shoqërisë nuk ka patur ndryshime.
Një pasqyrë e lëvizjeve të kapitalit dhe gjendjeve në fund të vitit 2017 e 2016, është :

Kapitali dhe Rezervat e disponueshme	Balanca Më 31.12.2016	Efekti nga sistemimet te para 2017	Balanca e Rregulluar Më 31.12.2016	Balanca Më 31.12.2017
Kapitali aksionar	30,083,349		30,083,349	30,083,349
Rezerva rivler. asetesh	1,513,463		1,513,463	1,250,030
Rezerva te tjera	2,916,011		2,916,011	2,916,011
	(88,770,269)	494,874	(88,275,395)	(69,292,022)
Te ardhura neto vjetore	18,719,939		18,719,939	1,830,160
Parapagimet per TF				
		494,874	(35,042,633)	**(33,212,472)**

Kapitali aksionar dhe rezerva te tjera nuk kanë ndryshuar nga viti i mëparshëm

Rezerva rivleresimi asetesh, ka ndryshuar në paksim nga sistemimi i rregullimit të amortizimit për asetet e rivlerësuara. Detaje gjenden tek pika 5 e këtyre shënimeve.

Humbjet e akumuluara janë paksuar në vlerën 19,478,246 mijë Lekë, ardhur kjo për këto arsye :

- Paksim nga sistemimi i rregullimit te rezervave te rivleresimit te aseteve, vlera 263,433 mijë Lekë, duke paksuar humbjen me të njejtën vlerë të ndikimit tek ë ;
- Paksim nga evidentimi i fitimit të vitit 2016 në vlerë 18,719,939 mijë Lekë ;
- Paksim nga efekti i rregjistrimit të shpenzimeve të periudhave të mëparshme, vlera 494,874 mijë Lekë.

Efekti nga rregjistrimet e shpenzimeve të periudhave të mëparshme, është i lidhur me marrjen në evidencë të faturave të prapambetura të KESh SHA e OST ShA sipas vendimit të organeve drejtuese të shoqërisë dhe me evidentimin faljes fiskale sipas ligjit 33/2017, konkretisht :

Faturat e KESH për energjinë elektrike dhe penalitete të periudhës deri në fund të vitit 2014, njohur si detyrim nga njera anë, kanë ndikuar në rritjen e humbjes së akumuluar nga ana tjetër, në vlerën 7,161,657 mijë Lekë, shënimi 17 mësipër	7,161,657
Faturat e OST të deri në vitin 2012, për tran smetimin e energjinë elektrike, kanë ndikuar në rritjen e humbjes së akumuluar në vlerën 100,450 mijë Lekë dhe vlera e penaliteteve të rregjistruara më parë në rezervë për detyrim nga ana jonë por pa u kërkuar nga OST në rakordimin e fundvitit 2016, ka ndikuar në uljen e humbjes së akumuluar në vlerën 2,353,776 mijë Lekë, shënimi 17 mësipër	(2,253,326)

Falja fiskale, ka ndikuar në paksimin e humbjes së akumuluar në vlerën 5,403,205 mijë Lekë, duke paksuar detyrimet ndaj Tatimeve për tatime/taksa/gjoba/kamatëvonesa të njoftuara nga vlerësimit tatimore të deri vitin 2014, të rregjistruar në librat kontabël të shoqërisë, shënimi 16 mësipër	(5,403,205)
Paksim i humbjes së akumuluar	**(494,874)**

14. Huamarrja

Shoqëria, ka detyrim për hua ndaj KESH sha e ndaj Ministria e Financave si dhe detyrim afat shkurtër ndaj CEZ a.s.

Huatë në PF janë paraqitur me vlerën e rivlerësuar në fund të periudhës të monedhave në valutë, duke ruajtur monedhën e disbursimit dhe kursim e këmbimit në momentin e disbursimit.

Huatë ndaj KESH sha, janë pjesë e detyrimeve që ju transferuan Shoqërisë, në momentin e ndarjes, KESH sha - OSHEEsha (ish OSSH). Për këto hua, është lidhur marrëveshje afatgjatë ripagimi, të firmosur ndërmjet KESH e OSSH në 10 Mars 2009 dhe marrëveshje e transferimit të Nënstacionit Bushat më datë 31.12.2010. Termat e huave ndryshojnë në varësi të maturitetit dhe normës së aplikuar të interesit.

Ndaj Minsitrisë së Financave kemi detyrim për :

- Hua afatgjatë të financuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, miratuar me Ligjin nr.170/2014 dt.11.12.2014 ;
- Hua afatgjatë (nga fondet e Ministrisë) për tu paguar deri në Tetor të vitit 2019 ;
- Hua afatshkurtër (nga fondet e Ministrisë) për tu paguar deri në Tetor të vitit 2018 ;

Detyrimi afat shkurtër ndaj CEZ a.s, përbën vlerën për tu paguar në Korrik 2018, të marrëveshjes për zgjidhjen me pajtim të detyrimeve sipas ligjit nr.114/2014 dt.31.07.2014, me afat shlyerje për katër vite. Në vitin e mbyllur, janë bërë pagesat përkatëse të detyrimit dhe interesit.

a. Huatë Afat Gjatë

Huatë janë marrë dhe i detyrohen institucioneve të mëposhtme:

Huadhënësi	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
KESH (Huatë 1 deri 16)	10,015,466	10,731,431
Ministria e Financave (Huaja 22)	2,500,000	0
CEZ A.S (Huaja 20)	2,737,129	5,463,511

Interesi i përllogaritur	582,227	557,032
Total	**18,745,484**	**17,744,057**

Në PF, detyrimi ndaj CEZ a.s me 31.12.2017 tregon detyrimin e maturuar dhe është njohur për diferencë ndërmjet detyrimit total në fund të periudhës (sipas marrëveshjes) vlera 2,803,029 mijë lekë, dhe vlerës së interesit të pamaturuar përfshirë në detyrim, vlera 65,900 mije lekë referuar llogarise (471 410) "Shpenzime të përllogaritura ndaj CEZ për Interesa".

Një listë e huave afatgjata (pjesa afatë gjatë e huasë), e ndarë sipas monedhës së disbursimit, normës së interesit sipas marrëveshjes dhe afatit të maturimit (për huate e KESH- nga fundi '2008 deri në periudhën e fundit të ripagimi) paraqitet si më poshtë vijon :

	Monedha	interesit	Maturiteti	2017	2016
Hua 1	JPY	2.30%	17.5 Vjet	1,170,313	1,463,410
Hua 2	KRw	3.00%	26.0 Vjet	558,505	609,290
Hua 3	USD	0.30%	32.0 Vjet	967,744	1,167,180
Hua 4	XDR	3.13%	8.5 Vjet	0	0
Hua 5	USD	3.13%	8.5 Vjet	0	0
Hua 6	EUR	4.06%	6.0 Vjet	0	0
Hua 7	EUR	0.40%	33.0 Vjet	986,775	1,003,697
Hua 8	EUR	2.00%	7.0 Vjet	0	0
Hua 9	EUR	1.00%	22.0 Vjet	131,118	144,481
Hua 10					
Hua 11	EUR	0.75%	31.5 Vjet	479,177	510,064
Hua 12	EUR	0.75%	35.5 Vjet	902,439	953,912
Hua 13	EUR	0.75%	4.5 Vjet	0	0
Hua 16	EUR	4.77%	15.0 Vjet	264,888	301,165
Hua 20	EUR	3.79%	4.0 Vjet	0	2,785,199
Hua 21	ALL	0.75%	21.5 Vjet	2,910,662	992,083
Hua 22	ALL	0.25%	1.5 Vjet	1,000,000	0
				10,540,409	**11,119,314**
	Pjesa Afatshkurtër e huave afatgjata			**7,205,075**	**6,624,743**
TOTAL Hua Afatgjata					

Sipas listës, huate në numrin rendor 14 dhe 15 janë me balancë zero pasi kanë përfunduar së ripaguari.
Në vitin 2017, kemi keto ndryshime të huave afat gjatë ;

- Huatë nga KESH paksuar me pjesen afat shkurter (kështet e vitit 2018) ;
- Detyrimi afatgjatë ndaj CEZ AS, është bërë zero duke mbetur balanca pagesës në 2018 ;
- Shtesë e huasë nga MOF (e financuar nga IBRD), disbursime ;
- Shoqëria ka marrë Hua afat gjate (me afat dy vite) nga Ministria e Finanacave, vlera 1,500,000 mijë leke e cila është disbursuar gjatë 2017. Balancës në fund të periudhës i është zbritur kësti afatshkurter.

Lista e kredive për pjesën afatshkurtër të huave afatgjatë (përfshirë interesin e maturuar të papaguar) është e detajuar si më poshtë vijon:

	Mon	Hua AfShk	Interesat e Huave sipas Marreveshjeve
Huaja 1	JPY	962,088	Interesi i huasë fiks 2.30%
Huaja 2	KRW	316,916	Interesi i huasë fiks 3.00%
Huaja 3	USD	81,497	Interesi i huasë fiks 0.30%
Huaja 4	XDR	759,884	Interesi i huasë fiks 3.13%
Huaja 5	USD	230,855	Interesi i huasë fiks 3.13%
Huaja 6	EUR	730,180	Interesi i huasë fiks 4.06%
Huaja 7	EUR	15,524	Interesi i huasë fiks 0.40%
Huaja 8	EUR	88,866	Interesi i huasë fiks 2.00%
Huaja 9		61,507	
Huaja 10	EUR	11,720	Interesi i huasë fiks 0.25%
Huaja 11	EUR	128,322	Interesi i huasë fiks 0.75%
Huaja 12	EUR	208,020	Interesi i huasë fiks 0.75%
Huaja 13	EUR	158,558	Interesi i huasë fiks 0.75%
Huaja 16	EUR	214,009	Interesi i huasë fiks 4.77%
Huaja 20	EUR	2,737,129	Interesi i huasë fiks 3.79%
Huaja 22			
Totali		**7,205,075**	

Huatë ndaj KESH

- **Interesi i maturuar.** Gjatë vitit 2017, shoqëria ka paguar KESH-it interesa të maturuara të viteve të mëparshme, vlera 37,410 mijë Lek. Detyrim i papaguar në fund të periudhës, vlera 582,227 mijë leke, është përfshirë në pjesën afat shkurtër të huave.

- **Pjesa afatshkurtër e Huave Afatgjata.** Shoqëria ka paguar ne vitin 2017 detyrime të prapambetura ndaj KESH në vlerën 135,326 mijë Lek. Detyrimi në fund të vitit i principalit të huave është vlera 3,060,271 mijë Lek, dhe përfshin detyrimin e maturuar (të papaguar te 2013-2017) vlera 2,653,843 mijë Lek si dhe pjesën afat shkurtër (për tu paguar) në vitin 2017 vlera 406,428 mijë Lek.

Për detyrimet e maturuara po vlerësohet mundësia e pagesave apo kompensimeve dypalëshe.

Detyrimi ndaj CEZ :

Detyrimi, sipas Marrëveshjes, në fund të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetort 2017 :

- Principal - Detyrimi afat gjate, vlera	0
- Principal - Detyrimi afat shkurtër, vlera	2,803,029
Totali - Detyrimi sipas Marrëveshjes	**2,803,029**

Në vlerën e detyrimit, përfshihet edhe detyrimi për interesin i pamaturuar :

a. Detyrimi afat gjate - interes	0
b. Detyrimi afat shkurter - interes	65,900
Totali - Detyrimi për Interesin	**65,900**

Në PF, detyrimi ndaj CEZ a.s me 31.12.2017 tregon detyrimin e maturuar dhe është njohur për vlerën 2,737,129 mijë lekë, rezultuar nga diferenca ndërmjet detyrimit total në fund të periudhës (sipas marrëveshjes) vlera 2,803,029 mijë lekë, dhe vlerës së interesit të pamturuar përfshirë në detyrim, vlera 65,900 mij lekë referuar llogarive (471400 & 410) "Shpenzime të përllogaritura ndaj CEZ për Interesa".

Huaja nga MOF e financuar nga IBRD

Gjatë vitit 2017, nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), është bërë disbursim i huasë në referencë të Marrevëshjes së NënHuasë lidhur me Minsitrinë e Financave.
Disbursimi është bërë në dy mënyra, duke transferuar/disbursuar në llogari të shoqërisë vlerën 6,466,254 Euro dhe nëpërmjet pagesës për Letër Kredinë vlera 7,742,352 Euro.
Shoqëria ka aplikuar marrjen e Leter Kredisë, si garanci për likujdimin e furnitorit. Nga IBRD është bërë likujdimi direkt i furnitorit duke paksuar pas çdo pagese vlerën e mbetur të Letër Kredisë.
Nga vlera e fillestare e Leter Kredisë, 14,294,894.40 Euro, në fund të vitit, më 31.12.2017, vlera e mbetur e Leter Kredisë është 4,398,591.53 Euro.

Gjatë vitit 2017, janë paguar interesa vlera 11,443 mijë Lek për vlerën e disbursuar të Huasë nga Ministria e Financave të financuar nga IBRD.
Në periudhën në vazhdim pritet të disbursohen vlera të tjera të kësaj huaje deri në përmbushjen e Marrëveshjes së Huasë.

b. Hua afat shkurtër.

Në vitin 2017 shoqëria ka marrë hua afat shkurtër nga Ministria e Financave, vlera 1,000,000 mijë leke me interes 0.25%.

15. Llogaritë e Pagueshme (Furnitorë)

Llogaritë e pagueshme të Shoqërisë, në fund të periudhës tatimore më 31 Dhjetor 2017 dhe në vitin 2016, paraqiten si vijon:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Furnitorë të tjerë	3,390,100	2,089,106
Të tjerë furnitorë energjie nga importi	8,339,225	866,497
Të tjerë furnitorë energjie-HC Lokale	891,966	890,748
Kuota e trasmentimit (OST)	9,065,687	7,977,515
Furnitorë për investime	3,764,103	1,429,532

Furnitorë të huaj	109,174	162,565
Furnitorë parapagim	(65,685)	0
Totali	**72,197,636**	**45,817,313**

Detyrimet ndaj furnitorëve lidhen kryesisht me blerjen e energjisë elektrike dhe me kryerjen e investimeve.

Gjatë vitit 2017, sigurimi i sasisë së nevojshme të energjise elektrike, është bërë duke blerë energji elektrike nga Hidrocentralet lokale, KESH ShA dhe Shoqëritë importuese.

Detyrimi ndaj shoqërinë KESH ShA ka rritje nga viti i kaluar vlera 14 mld Lekë, ardhur si rezultat :

- Shtesë detyrimi nga njohja e faturave papranuara më parë nga OSHEE ShA, por vendosur të pranohen nga drejtimi i shoqërisë, vlera 19,6 mld Leke ;
- Paksim detyrimi vlera 3,4 mld Lekë, i faturave të blerjes energjisë për mbulim humbje, duke i sistemuar në energji nga importi ;

Detyrimi ndaj shoqërinë OST ShA, për transmetimin e energjisë, ka rritje për vlerën 1 mld lekë duke ndikuar, marrja në evidencë e faturave të prapambetura të panjohura më parë nga OSHEE, vlera 0,6 mld Leke. Ndërsa detyrimet për disbalancat në fund të periudhës janë kompensuar, vlera 0,5 mld lekë sipas marrëveshjes dypalëshe.

Furnitorët e energjisë nga importi ka shtesë detyrimi në fund të periudhës, krahasuar me periudhën e mëparshme, vlera 7,5 mld Lekë. Kjo rritje ka ardhur nga blerja e energjisë elektrike nga importuesit në muajit e fundit të vitit 2017 dhe mbetur detyrim gjendje në fund të periudhës, kryesisht, ndaj :

- EFT - Zvicër, detyrimi 1mld Lekë ;
- GEN I Tirane, detyrimi 2 mld Lekë ;
- GSA shpk, detyrimi 1 mld Lekë ;
- KESH me çim importi, detyrim, vlera 3,5 mld Lekë.

Kemi rritje të detyrimeve ndaj furnitorve të tjerë, ku ata për investime kanë peshën kryesore, rritje vlera 2 mld Lekë.

16. Detyrime për taksat dhe sigurimet shoqërore

Detajet e këtyre llogarive janë si vijon:

Detyrimi	2017	2016
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	111,361	110,228
Kuota e sindikatës	1,101	1,022
TVSH e pagueshme neto	842	150,669
Shteti Tatim Taksa	2,439,568	7,857,253

Instituti ishperndjekurve Politik	39,724	0
Të tjera	6,092	4,862

Detyrimet per sigurime, sindikatë, TAP dhe TVSh, janë detyrimet koherente për pagesë.

Detyrimi ndaj Institutit ish perndjekurve Politik, vler 39,724 Lekë përbën detyrimin e llogaritur 1% mbi fondin e pagave të vitit 2017 por të papaguar në fund të periudhës.

Detyrimet evidentuar për Tatime e Taksa, në vlerën 2,439,568 mijë lekë, përbëjnë gjobat e kamatëvonesat në vitet 2015-2017 të lidhura me Tatim Fitimin e papaguar, rakorduar këto me organet tatimore në fund të periudhsës tatimore 2017.

Falja Fiskale

Gjatë viti 2017 është marrë në evidencë kontabël efekti nga Falja fiskale në zbatim të ligjit nr.33/2017. Në SIT u evidentuan veprimet e fshirjes/faljes të bëra nga organet tatimore (referuar edhe shkresave përkatëse nga Tatimet) dhe vlerat e rezultuara nga Falja, detyrime të periudhës deri më 31 Dhjetor 2014, janë :

Lloji Tatimit	Detyrimi-Principal	Gjoba/ kamatevonesa	Shuma e Faljes
Tatimi mbi fitimin	2,068,999	2,207,467	4,276,466
Kontribute Shoqërore	-	366	366
Tatim i Mbajtur në Burim	-	5	5

Rakoordimi me Tatimet

Në fund të periudhës tatimore, nga ana e shoqërië janë nxjerrë nga SIT detyrimet tatimore të periudhës së mbyllur.

Duke qenë se SIT, nuk nxjerr detyrimin e saktë të datës së mbylljes periudhës në datat e mëvonshme, pas kërkesës, organeve tatimore kanë dëërguar informacionin i balancës së detyrimeve tatimore të datës 31.12.2017.

Detyrimet për gjobat dhe kamatëvonesat e gjeneruara nga SIT, u morën në evidencë kontabël dhe detyrimet sipas Pasqyrave Financiare janë të rakorduara me detyrimet në SIT në fund të periudhës.

17. Detyrime të tjera afatshkurtra

Detyrime të tjera afatshkurtra lidhen me paga të pagueshme personelit, të pagueshme për Tarifën e TV si dhe me krededitorët e tjerë e shpenzimet e llogaritura, sipas ndarjes së mëposhtëme :

Detyrimi	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhietor 2016
Paga të pagueshme	337,863	332,641

Taksa e televizorit	106,811	103,978
Kreditorë të tjerë	783,219	906,085
Shpenzime të llogaritura	6,188,219	13,307,690
Total	**7,661,495**	**14,673,561**

Dy treguesit e parë kanë të bëjnë me detyrimet koherente për pagesë, pagat e punonjësve dhe tarifa e përdormit të aparateve TV ku shoqëria është në rolin e agjentit.

Tarifa konçensionare, është detyrimi i evidentuar ndaj Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë, për vlerën e tarifës së konçesionit, detyrim i HC lokale sipas marrëveshjeve të konçesionit mbi sasinë e energjise elektrike të faturuar. Detyrimi është i periudhës nga Korriku 2016 deri në fund të vitit 2017.

Gjendja e Kreditorë të tjerë ka balancë në fund të periudhës :

- Detyrimet ndaj kreditorve të ndryshëm vlera 238,751 mijë lekë nga e cila vlera 200,000 mijë Lekë është diferenca e fondit të Ministrisë Brendshme transferuar për shërbimin në proces të evidentimit të adresave, dhe,
- Balancën e llogarive të ndryshme në proces shqyrtimi, vlera 544,468 mijë Lekë, për diferenca të pa indentifuara analitikisht nga periudhat e mëparshme, kjo deri në vendimmarrje nga drejtimi i shoqërisë.

Shpenzimet e llogaritura përbëjnë vlerën kryesore të këtyre detyrimeve dhe një ndarje sipas natyrës, paraqitet si më poshtë:

	2017	2016
Shërbime Postar e Arketim fatura	47,411	336,066
Energji e përllogaritur	4,507,426	8,079,713
Shërbimi i trasmetimit të energjisë	0	498,179
Të përllogaritura të tjera	1,610,080	4,393,732
Totali i Shpenzimeve të Llogaritura	**6,164,917**	**13,307,690**

Shërbime nga Posta :

- Në vitim tatimor 2017, ka paksim vlera 288,703 mijë Lekë, nga marrë në evidencë kontabël të faturave të Postës Shqiptare të papapranuara me parë nga OSHEE, vendosur nga Drejtimi i shoqërisë për evidentimin e tyre pas rakordimit dhe verifikimit nga një Ekspert i pavarur, shkresa nga Ministri i MIE nr.7470/3 dt.19.12.2016, rregjistruar më parë në detyrime të përlogaritura ;
- Vlera 47,411 Lekë, shpenzime të përllogaritura, përbën vlerën e shërbimeve sipas faturave të fundvitit 2017 nga Posta Shqiptare, të paardhura brenda periudhës raportuese.

Energjia e përllogaritur, përbëhet nga kostot e përllogaritura të blerjes së energjisë deri në fund të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetor 2017, kjo kryesisht nga furnitorët si më poshtë :

- HC lokale, vlera 1,130,848 mijë Lek, për energjinë elektrike të blerë në fund të periudhës së mbyllur dhe që nuk erdhën faturat përkatëse ;
- GSA Shpk, vlera 1,936,244 mijë Lekë, blerje energjie elektrike në Dhjetor 2017 ;

- EFT AG , vlera 1,216,587 mijë Lekë, për faturat e dhjetorit 2017 ;
- Te tjera shoqëri importuese, vlera 181,955 mijë Lekë.

Të tjera, përbehet nga fatura të investimeve vlera 1,409,355 mijë Lekë dhe kostoja e shërbimeve tjera sipas faturave të ardhura me vonesë në OSHEE.

<u>KESH dhe OST</u> Në pasqyrat financiare të vitit 2017, janë pasqyruar edhe veprimet e rregjistrimit të faturave të prapambetura të KESH ShA, OST ShA dhe Posta Shqiptare ShA, vendosur nga drejtimi i shoqërisë, sipas shkresës nga Ministri i MIE nr.3664/12 dt.23.03.2018.
Efektet e këtyre veprimeve, në "Detyrimet e tjera afatshkurtra", janë sipas shoqërive :

- KESH ShA, paksim vlera 10,247,473 mijë Lekë, nga sistemimi i rregjistrimit të faturave të energjisë elektrike vlera 6,731,402 mijë Lekë dhe faturave të penaliteteve vlera 3,695,851 Lekë, të rregjistruara më parë në detyrime të përllogaritura ;
- OST ShA, paksim vlera 482,188 mijë Lekë nga sistemimi i rregjistrimit të faturave të transmetimit të energjisë elektrike të rregjistruara më parë në detyrime të përllogaritura ;

18. Provizionet

Ndarja e Provizioneve në zëra është si më poshtë

	2016	I përllogaritur	. .. .	Dhjetor 2017
Provizione të tjera	4,753,465	(4,569,416)	+ 226	184,274
Çështje gjyqësore	870,327	0	+ 1,930,054	2,800,381
Provigj. afatshkurtra	5,623,792			2,984,656
Provigjione afatgjata	-			-

Paksimi i provizine të tjera i përket sistemimit të faturave të prapambetura të KESH dhe OST me efekte : faturat e KESH vlera 2,181,322, faturat e OST vlera 2,353,776 mijë Lek. Vlera 34,319 mijë Lek i përket provizioneve tjera, taka vendore e TVSH.
Pjesën kryesore të provizionit gjendje në fund të periudhës 2017, e përbën vlera e përllogaritur për çeshtjet gjyqësore e cila ka pësuar shtesë gjatë vitit 2017 në vlerën 1,930 mln Lek.

19. Të Ardhurat nga Shitja e Energjisë

Të ardhurat e Shoqërisë paraqiten si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Familjarët	25,479,245	24,856,692
Konsumatorët privatë	20,389,060	19,777,246
Shitja totale e energjisë (e faturuar)	52,893,726	51,267,345
Tarifat e lidhjes (të faturuara)	649,137	540,865

Totali	**53,542,863**	**51,808,210**

Këtu janë evidentuar të ardhurat nga shitja e enegjisë elektrike dhe tarifa e lidhjeve të reja. Ndërsa të ardhurat nga qiratë dhe diferenca çmimi, janë klasifikuar tek kategoria e të ardhurave të tjera, shënimi më poshtë.

20. Të Ardhura të Tjera

Gjatë vitit 2017, të ardhurat e tjera të Shoqërisë janë të përbëra sipas tabelës më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Shërbimet	44,380	21,596
Të ardhura nga penalitetet për pagesa me vonesë	6,701,221	1,727,153
Të ardhura nga shitja e Aktiveve fikse	1,500	0
Qiratë	996	680
Të ardhura nga diferenca çmimi	6,632	3,873
Totali	**6,889,472**	**10,215,645**

Të ardhura nga penalitetet janë rritur në vitn 2017, ardhur nga mosrealizimi i kontratave të furnizmit si të energjisë elektrike ashtu edhe investimveve e shërbimeve tjera. Vlerën kryesore e përbën të ardhurat nga faturimi i penaliteteve të KESH vlera 5,465,033 mijë Lekë.

Të Tjera kanë të bëjnë kryesisht me përqindjen nga mbledhja e Tarifës së TV.

Të ardhurat nga diferencat e çmimit i përkasin diferencave të çmimit të materialeve të blera dhe çmimit të rregjsitrimit në SAP për shifrat pas 2 numrave pas presjes, ndikuar për blerjet nga Elkabel JSC vlera 6,194 mijë Lekë dhe Tehno Burimi vlera 345 mijë Lekë.

21. Blerje e energjisë elektrike

Shpenzimet për blerjen e energjisë elektrike për vitin 2017 klasifikohen si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Energji elektrike - Nga KESH me çmim të rregulluar	4,170,670	9,760,582
Energji elektrike - Prodhim vëndas me çmim tregu	297,080	786,770
Energji elektrike e importuar	22,506,040	7,548,605
Totali	**34,966,858**	**21,737,924**

Sasia e blerë në MëH	**6,498,514**	**6,399,716**

Struktura e blerjes së energjisë elektrike ka dryshuar në vitin 2017 në krahasim me vitin 2016, ku ndikim kyesor ka situata e tejzgjatur e mungesës së reshjeve gjatë vitit duke ndikuar në uljen e prodhimit vendas të energjisë.

Blerja nga KESH ShA ka patur ndikimin më të madh nga mungesa e reshjeve, duke ulur sasinë e blerë në më pak se gjysma e sasisë vitit 2016.

Blerja nga HC Lokale ka shtesë pasi në vitin 2016 blerja është vetëm për periudhën Korrik-Dhjetor 2016.

Blerja energjisë nga Importi, është gati trefishur në vlerë në krahasim me vitin e mëparshëm, ardhur kjo nga rritja e sasisë së blerë me gati 60% më shumë se në vitin 2016 dhe nga rritja e çmimit mesatar të blerjes në vitin 2017 me gati 71% të çmimit mesatar të blerjes në vitin 2016.

Transmetimi i energjisë dhe Disbalancat

Në vitin 2017 treguesit e transmetimit të eenergjisë elektrike nga OST si hde marrëdhëniet për disbalancat e energjisë, janë :

	Më 31 Dhjetor 2017	**Më 31 Dhjetor 2016**
Disbalanca në blerje	1,036,543	201,187
Disbalanca në shitje	(394,133)	(109,125)
Totali	**4,639,553**	**3,927,551**

Në krahasimin e disbalancave, rezulton një rritje e treguesit në blerje dhe në shitje, ardhur kjo edhe nga baza krahasuese, ku viti 2016 është vetëm për pjesën Korrik-Dhjetor jo për gjithë vitin.

22. Shpenzime të personelit

Ky zë përmban pagat dhe kontributet për sigurime shoqërore si dhe të tjera përfitime që mund të kenë patur punonjësit.

	2017		**2016**	
	Total	**Stafi Menaxh.**	[illegible]	**Menaxh.**
Paga bazë	4,224,475	4,217	3,317,341	3,122
Kompensime të tjera	1,143,249		1,028,672	
Kontributet 1% mbi page për Institutin Ish Perndjekurve Politik	70,490	-	0	-
Totali	**6,254,604**	**4,217**	**5,001,793**	**3,122**
Numri mesatar i punonjësve	6,376		6,055	

Shpenzimet për paga të Stafit Menaxherial, janë ato të paguara për Këshillin Mbikqyrës të shoqërisë.

23. Shpenzime të tjera, neto

Në këtë grup shpenzimesh, janë përfshirë shërbimet e tjera të blera nga palët e treta, qiratë, gjoba e penalitete ndaj tatimeve dhe sipas vendimeve gjyqësore, taksa e tarifa të tjera, provizione të krijuara për klientët e debitorët, të detajuara si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Shërbime nga të tretë (të nënkontraktuar)	2,327,590	2,386,763
Qera	469,302	412,117
Gjoba e penalitete	1,528,681	2,875,653
Krijimi dhe kthimi i Provigjionimeve tjera	2,480,918	(721,800)
Krijimi i Zbritjeve për Llogaritë e Arkëtueshme	29,197	
Zhvleresim astetesh	0	842,721
Krijimi/(Rimarrja)iZbritjeve për inventarët	141,437	110,951
Totali	**7,690,145**	**6,348,813**

Vlera e provizionit i përket kryesisht provizionit të çeshtjeve ligjore vlera 1,930 mln Lekë dhe provizionit të TVSh nga humbja e energjise elektrike vlera 575 mln Lekë.

24. Shpenzimet Financiare, neto

Shpenzimet financiare të Shoqërisë përbëhen si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Shpenzime Interesi	(268,941)	(399,242)
Të ardhura nga depozitat bankare afatshkurtra	22,058	78,882
Të tjera shpenzime financiare (garancitë)	(269,252)	(347,556)
Rezultati neto nga diferencat e kursit kemb	499,619	
Totali	**(16,515)**	**(839,890)**

Rezultati Neto nga diferencat e kursit të këmbimit :

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Fitime nga kursi i këmbimit (a)	1,035,282	314,341
Humbje nga kursi i këmbimit (b)	(535,662)	(486,316)
Totali	**499,619**	**(171,975)**

a) Fitime nga kursi i këmbimit

Fitimet nga kursi i këmbimit vijnë si rezultat i efektit të ndryshimit të kurseve në llogaritë e mëposhtme:

	2017	2016
Depozita bankare	46,023	21,955
Furnitorë	268,734	68,327
Të tjera	6	29
Totali	**1,035,282**	**314,341**

b) Humbje nga kursi i këmbimit

Humbjet nga kursi i këmbimit vijnë si rezultat i efektit të ndryshimit të kurseve në llogaritë e mëposhtme:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Depozita bankare	508,511	296,119
Kredi	18,367	135,683
Të tjera	71	170
Totali	**535,662**	**486,316**

25. Informacion mbi Palët e lidhura

Duke qenë shoqëri me kapital 100% shtetëror, marrëdhëniet me palët e lidhura përfshijnë aktivet dhe detyrimet që lidhen me shoqëritë me kapital shtetëror dhe institucionet buxhetore.
Më poshtë është informacioni për periudhën tatimore 2017 dhe 2016 :

A. Aktive afatshkurtra -të arkëtueshme	**Më 31.12.2017**	**Më 31.12.2016**
Institucione dhe njësi të zotëruara nga shteti	1,308,877	1,075,589
Kliente tarife transmetimi	-	42,001
Te arketueshmenga KESH	-	-
Debitore lidhje re	7,514	8,456
Shuma A - Të Arkëtueshmeve	**1,316,391**	**1,126,046**
B. Detyrime Afatshkurtra		
Të pagueshme ndaj KESH për blerjen e energjisë	45,314,932	32,320,767
Shpenzime të llogaritura e të tjera për KESH Sh.a		10,272,937
Provizion per gjobat nga KESH	-	2,181,322
Kesh Asete	17,400	17,400
Kesh sl Durres	16,864	16,864
Shuma e detyrimeve ndaj KESH	**45,349,196**	**44,809,290**
Të pagueshme ndaj OST-tarifën e transmetimit	9,122,336	8,062,984
Shpenzime të llogaritura për OST	-	482,188
Shpenzime të llogaritura për OST disbalancë	3,139	15,992

Provizion per gjobat nga OST	-	2,353,776
Ost rigjenerim	678	678
Shuma e detyrimeve ndaj OST	**9,126,153**	**10,915,618**
Të pagueshme tregtare ndaj Postës Shqiptare	126,335	769,984
Shpenzime të llogaritura për Posta Shqiptare	42,041	343,996
Shuma e detyrimeve ndaj Postes	**168,376**	**1,113,980**
Të pagueshme tregtare ndaj Ujesjellsit	21,250	20,168
Shpenzime të llogaritura për Ujesjellsat	364	145
Shuma e detyrimeve ndaj Ujesjellsave	**21,614**	**20,313**
Taksa të tjera të pagueshme	2,686,599	7,882,498
Tatim fitimi	4,035,125	5,442,125
TVSH e pagueshme, neto	842	150,669
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	111,361	110,228
Tatimi mbi të ardhurat personale	74,188	71,788
Tatimi në burim	4,444	2,786
Tatim 1% te perndjekur	39,724	
Të pagueshmet për taksën e televizionit	106,811	103,978
Shuma e detyrimeve ndaj Tatimeve	**7,059,094**	**13,764,072**
Shuma B - Detyrime afatshkurtër	**61,724,433**	**70,623,273**
C.Detyrimet Afatgjatë	**61,724,433**	**70,623,273**
KESH Sh.a	10,597,693	11,288,463
Ministra e Financave (Hua nga IBRD)	5,410,663	992,083
Shuma C - Detyrime afatgjatë	**16,008,356**	**12,280,546**
D.Të ardhura :		
Shoqëri publike	7,025,422	6,633,408
Te ardhura nga disbalanca	394,133	109,125
Te ardhura lidhje re	44,224	20,747
Te ardhura nga penalitettet	5,465,003	-
Te ardhura nga kamatevonesat	109,899	975
Shuma D - Të Ardhura	**13,038,681**	**6,764,255**
E.Shpenzime :		
KESH - për mbulim i humbjeve	4,672,482	12,317,631
Tarifa transmetimi	5,033,686	4,036,676
Shpenzime me Posta Shqiptare	511,852	501,093
Shpenzime Ujesjellsi	4,477	6,387
Shpenzime interesi me KESH	93,218	117,172
Shpenzim 1 % te perndjekur	70,490	
Shpenzime interesi Ministria	14,092	5,847
Shuma E - Shpenzime	**10,400,297**	**16,984,806**

26. Llogaritja e Tatimit mbi Fitimin

Përbërësit e Tatimit mbi Fitimin të përllogaritur janë si më poshtë:

Tatimi mbi Fitimin	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Tatimi mbi fitimin e llogaritur	(1,575,808)	(2,636,434)
Tatimi i shtyrë	-	-

Llogaritje :	Ushtrimore 2017	Tatimore 2017
Të Ardhurat	60,432,335	60,432,335
Shpenzimet	(57,026,368)	(57,026,368)
Të panjohura		7,099,416
Fitim / (Humbja)	**3,405,967**	**10,505,383**
Tatim Fitimi (15%)		1,575,808
Tatim Fitimi Parapagime		0
Tatim Fitimi për tu paguar		1,575,808

Të dhëna për shpenzimet e panjohura sipas natyrës së shpenzimit, janë si më poshtë, në lekë :

Shpenzimet e panjohura :	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Blerje energjie	2,876,835.300	715,332,766
Uje	35,856,789	2,612,900
Shpenzime nga sherbime tjera	41,080,415	8,074,822
Shpenzime ligjore e permbarimore	54,807,396	145,585,864
Shpenzime per Taksa	822,633	0
Shpenz. Penalitete, Gjoba e Demshperblime	1,528,680,806	2,875,652,816
Shpenzime Financiare	(202,195,639)	658,450,695
Shuma te parashikuara per shpenzime	2,651,552,675	231,872,474
Totali	**7,099,416,201**	**4,551,265,866**

Diferencat ndërmjet shpenzimeve dhe tatimit mbi fitimin, të llogaritura sipas normës ligjore dhe shpenzimeve të tatimit mbi fitimin të siguruara nga fitimet para tatimit janë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Norma ligjore e tatimit mbi fitimin në Shqipëri	15%	15%
Llogaritja e "parashikuar" e tatimit mbi fitimin	1,575,808	3,203,456
Efekti tatimor i:		21,356,374
Ndryshime në normën ligjore dhe fiskale	0%	0%
Shpenzime të pazbritshme	7,099,416	4,551,266
Të ardhura të tatuara ose të përjashtuara	-	8,331,410
Rregullime në lidhje me tatimin aktual mbi fitimin për periudhat e mëparshme	-	-
Ndryshimi në taksat e shtyra të Arkëtueshme e të paregjistruara	-	-
Norma efektive e tatimit mbi fitimin	**-15%**	**-12%**

Tatim mbi fitimin Aktiv/Detyrim

Tatimi mbi Fitimin Aktiv/ Detyrim në 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016:

arkëtueshëm/(Detyrimi)	**2017**	**2016**
Çelja	**(5,442,125)**	**(4,110,983)**
Parapagimet/Pagesa	1,007,000	1,300,000
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	(1,575,808)	(2,636,434)
Sistemim	400,000	0
Kompesim detyrimesh	0	5,292
Gjëndja në fund	**(5,610,933)**	**(5,442,125)**

Gjatë vitit 2017 janë kryer pagesa për tatim fitimin vlera 1,007,000 mijë Lek dhe është bërë sistemim i Tatim Fitimit në vlerën 400 mijë lekë, sipas miratimin nga DRTTM.
Gjendja në fund, vlera 5,610,933 mijë lekë, përfaqëson detyrimin për tu paguar ndaj Tatimeve.

27. Menaxhimi i kapitalit

Një nga qëllimet kryesore të Shoqërisë mbetet ruajtja e një prirjeje pozitive dhe për të përmirësuar përfitimet e Shoqërisë, jo vetëm për mbështetjen e planeve të investimeve, por edhe për konsolidimin e mëtejshëm dhe stabilizimin e strukturës së kapitalit në vitet në vijim.
Të dhënat për strukturën e Kapitalit në fund të vitit tatimor 2017 dhe 2016, janë :

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Totali i huasë afatashkurtër	7,205,076	6,624,743
Totali i borxhit	**18,745,485**	**17,744,057**

Më Pak: Aktive Monetare	(4,135,776)	(6,739,895)
Totali i borxhit, neto	**14,609,709**	**11,004,162**
të tjera (Shpenzime)	3,422,482	22,196,262
Plus: Zhvlerësimi dhe amortizimi	2,528,909	1,835,305
Humbja para Interesave, tatimit mbi fitimin, zhvlerësimit dhe amortizimit	**5,951,391**	[illegible]
Kapitali Aksioner total	(33,212,481)	(35,537,506)
Borxhi total	18,745,485	17,744,057
Kapitali total	**(14,466,966)**	
Raporti Borxhi/Kapital	**- 129.57 %**	**- 99.72 %**

28. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara

Angazhimet e qerasë operacionale - Shoqëria si qeramarrës

Shoqëria ka firmosur marrëveshje të qirave operative, në lidhje me disa ndërtesa. Kontratat e qirave kanë një jetëgjatësi mesatare midis 1 viti deri në 3 vjet dhe me opsion rinovimi.

Nuk ka kufizime të vendosura mbi qiramarrësin që rrjedhin nga këto marrëveshje qiraje.

Shpenzimet e qirave operative në periudhën korrente, viti 2017, për ndërtesat janë 288,947 mijë Lek nga viti 2016 vlera 257,632 mijë Lek.

Këtu përfshihet edhe Marrëveshja e huapërdorje me KESH SHA për marrjen në përdorim të disa ndërtesave në Durrës. Marrëveshja parashikon detyrimin e shoqërisë OSHEE për të riparuar ndërtesat e ambjentet dhe për ti përdorur ato për pesë vite pa pagesë qeraje. Vlera e shpenzimit për riparimin e përfunduar është 51,355 mijë Leke dhe kosto e shpërndarë që i përket vitit të mbyllur 2017 është vlera 9,393 mijë Lek. Pjesa tjeter do të shpërndahet në shpenzimet e viteve të ardhshme. Marrëveshja nuk ka kushtëzime për qiramarrësin.

Gjithashtu shoqëria ka kontratë qiramarrje për automjete me afat 1 dhe 3 vjeçar me të drejtë rinovimi. Shpenzimet e qirave në periudhën tatimore të mbyllur, për automjetet, janë 164,579 Lek. Dy kontrata janë me afat deri në Shtator 2019 dhe një kontratë deri në Mars 2020.

Detyrimet e kushtëzuara - Çështjet ligjore

Gjatë veprimtarisë së saj, Shoqëria është përfshirë në çështje të ndryshme ligjore. Shoqëria kryen vlerësimin e probabilitetit të të fituarit apo humbjes së çështjeve dhe në rastet kur është e mundur që të ndodhë një dalje fluksesh monetare, atëhere krijon provizionet për shpenzime.

Gjatë vitit 2017 Shoqëria ka qenë e përfshirë në një numër çështjesh ligjore, me klientë konsumatorë të energjisë, me subjekte tjera paditës, ish-punonjës, Njesi vendore, etj. Ndërkohë shoqëria u padit gjatë periudhës, në 485 raste me vlerë të pretenduar 3,769 mln Lek.

Në fund të vitit 2017, janë 525 çeshtje të përfunduara me vlerë të pa ekzekutuar/paguar 1,291 mln Lek dhe 284 çeshtjeve në proces gjyqësor me vlerë të pretenduar 3,808 mln Lek / të pranuar nga gjykata (pjesërisht) vlera 2,203 mln Lek . Duke ju referuar tendencës dhe mesatares së tre viteve të fundit të humbjes së këtyre çeshtjeve, është llogaritur provizioni vlera 2,800 mln Lek.

29. Ngjarje pas datës së bilancit

Krijimi i Shoqërive për ndarjen aktivitetit. Në bazë e për zbatim të ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", Drejtimi i shoqërisë, vendosi në Shkurt 2018, krijimin e tre shoqërive aksionere të kontrolluara, me qëllim ndarjen e aktivitetit të shpërndarjes, shërbimit universal të furnizimit dhe aktivitetit të shitjes në tregun e lirë të energjisë elektrike. Shoqëritë e krijuara dhe të rregjistruara janë :

- Shoqëria - Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL ShA) me objekt veprimtarie : blerjen dhe menaxhimin e energjisë dhe operimin në tregun e lirë, etj ;
- Shoqëria - Furnizmi i Shërbimit Universal (FSHU ShA) me objekt veprimtarie : furnizimin me energji të klientëve të rregulluar si dhe sigurimin e cilësisë tregtare të shërbimit, etj ;
- Shoqëria - Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH ShA) me objekt veprimtarie : Shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit shpërndarës të energjisë elektrike, lidhjen e klientëve, intalimin dhe shërbimin e matjes së energjisë, etj.

Administratori i shoqërisë OSHEE ShA, do të ushtroi funksionet e përfaqësuesit të aksionerit në shoqëritë e kontrolluara të cilat do të jenë me një nivel administrimi.

OSHEE ShA si aksionere e vetme e tre shoqërive, financoi kapital themeltar për secilën nga shoqëritë vlerën 3,500,000 Lek, me vlerë nominale të aksionit 1,000 Lek. Shoqëria do të ndjekë të gjitha proçedurat ligjore për ndarjen e aseteve fikse dhe të llogarive financiare në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërive të kontrolluara, deri në fund të vitit 2018.

Marrëveshja me KESH për skedulimin e pagesave të detyrimit. Me qëllimin e shlyerjes së plotë të pakushtëzuar dhe përfundimtare të të gjithë detyrimit që OSHEE ShA ka ndaj KESH Sha, dy shoqëritë kanë nënshkruar më datën 6 Prill 2018 Marrëveshjen për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Sipas Marrëveshjes, gjithë detyrimi do të paguhet në pagesa vjetore, të skeduluara për pagesë që fillon në Tetor të vitit 2018 deri në vitin 2046, me pagesë vjetore deri ne vitin 2022 dhe nga viti 2023 me dy këste pagese në Prill dhe Tetor.

Kjo Marrëveshje do të ndihmojë shumë shoqërinë jo vetëm në menaxhimin e likujditeteve por edhe do të ndalojë ngarkesën me penalitete për vonnesa në pagesë të detyrimeve të KESH.

Politikat ekonomiko-finaciare mbeten të pandryshuara. Angazhimi i strukturave organizuese dhe gjithë punonjësve është në nivele shumë të larta për realizimin e objektivave për vitin 2018.